

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7826 E mërkurë 20 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**

Nëse një student i Juridikut, aktiv gjatë Lëvizjes së Dhjetorit 1990, bie në gjumë letargjik në 1994-n dhe zgjohet pas 25 vjetësh - më 2019-n - gjëja e parë që kërkon të dijë ...
Vijon në faqen 20

Nga LUTFI DERVISHI

Zgjidhja është zgjimi!



Opinion *i* **Ditës**

Nga PËLLUMB KARAMETA

Pedagogjia "inteligjente" dhe teknologjia dixhitale

1. Argumenti. Dy dekadat e fundit, në sistemin tonë arsimor filloi të përdoret teknologjia digjitale (në vijim, TD). Trajektorja e procesit, formalisht mund ...
Vijon në faqen 21



Përfituesit në Tiranë dhe në 18 qytete

ALUIZNI: 2300 pronarët që marrin paratë e kompensimit, lista e re me emrat

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, si ndahet fondi 50 milionë lekë të reja

ALUIZNI publikon listën me 2300 pronarë që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje dhe kanë gati kompensimin. Bëhet fjalë për 700 pasuri, ose rreth 2300 pronarë, pasi në secilin pasuri përfshihen emrat e disa trashëgimtarëve, të cilët përfitojnë një fond rreth 50 milionë lekë dhe iu kompensohet një sipërfaqe e përgjithshme prej rreth 11 866,63 m². Përfituesit janë në ...

Në faqen 10-12

DOSSJA/ PROKURORIA: BISEDAT E BORXHDHENESVE ME ISH-PREFEKTIN E SHKODRES

PERGJIMET E FAJDEVE: T'I VRAS DJEMTE PER 24 ORE

Fëmijët e Paulin Radovanit "fundosën" të atin biznesmen. Shiti pronat të paguante borxhet. Policia arrestoi 12 veta, sekuestroi rreth 500 mijë euro



(Në foto) Ish-prefekti i Shkodrës, Paulin Radovani

Në faqen 6

DYSHIMET E POLICISE

Vrasja e Kurtit, Vjollca Arapi: Nuk kemi lidhje, doja drejtësi, jo vdekje

Në faqen 7

KARAMELO: ME KERCUAN

KQZ u jep mandatin 3 deputetë të rinj, Kuvendi gati me 95 deputetë

Në faqen 4

KONCESION ABUZIV

Skandali i Sharrës, ministri Klosi nuk shpjegon arsyet e kundërvajtjes

Në faqen 8

RREFIMI I STILISTES

Rina Kuqo: Stili im s'ka rregulla të përcaktuara, e gjej veten kudo

Suplement

LEKSIONI TEK EKONOMIKU



Profesori amerikan te "Luarasi": "Marketoni" në sytë e Bashkimit Evropian

Në faqen 9

Opozita në protestë të enjten para Kuvendit, Paloka: S'ka zgjedhje me Ramën

PD-LSI kundër OSBE: Relativizon krimin elektoral

Përplasja, ambasadori Borchardt: Ndezët fitilin që i vë flakën sistemit

NGA VALENTINA MADANI

Opozita paralajmëroi dje se nuk do të hyjë në zgjedhjet për pushtetin vendor, nëse nuk largohet kryeministri Edi Rama. Sinjali i parë për bojkotin e zgjedhjeve lokale u dha dy



ditë më parë, kur PD dhe LSI nuk dorëzuan emrat e komisionarëve që do të përgatisin procesin zgjedhor të 30 qershorit. Megjithatë, ende nuk ka një vendim politik për bojkotin e procesit të 30 qershorit, por nënkryetari i PD-së, Edi Paloka ...

Në faqen 2-3

PROTESTAT OPOZITA

Aksioni politik në të gjithë vendin, opozita sërish të enjten në protestë

Opozita drejt bojkotit të 30 qershorit, Paloka: Jo zgjedhje me Edi Ramën

"Të ndërhyjnë ndërkombëtarët"

Valentina Madani

Opozita paralajmëroi dje se nuk do të hyjë në zgjedhjet për pushtetin vendor, nëse nuk largohet kryeministri Edi Rama. Sinjali i parë për bojkotin e zgjedhjeve lokale u dha dy ditë më parë, kur PD dhe LSI nuk dorëzuan emrat e komisionarëve që do të përgatisin procesin zgjedhor të 30 qershorit. Megjithatë, ende nuk ka një vendim politik për bojkotin e procesit të 30 qershorit, por nënkryetari i PD-së, Edi Paloka e bën të qartë se demokratët nuk do të hyjnë në zgjedhje pa u plotësuar kushtet e tyre. "Nuk ka zgjedhje në Shqipëri pa u larguar Edi Rama dhe pa u krijuar kushtet për zgjedhje të lira e të ndërshe", u shpreh nënkryetari demokrat. Sipas Palokës, emërimi i Damian Gjinkurit në postin e sekretarit për çështjet elektorale në PS është shenja më e keqe për fatin e zgjedhjeve. Z.Paloka komentoi edhe apelin e ambasadorit të OSBE-së, Bochar, për zgjedhjet lokale. "Si e sheh vendosjen e dosjes 184 në krye të zgjedhjeve nga Partia Socialiste, si ka mundësi që 20% e votave të blera nuk e ndryshojnë rezultatin, sepse në një parlament me 140 deputetë i bën 28 deputetë, pra 28 deputetë që ka marrë mazhoranca nuk e ndryshokan balancën, nuk e ndryshokan rezultatin e zgjedhjeve?! Pyetini edhe për këtë se, mbase ju japin përgjigje". Vendimi i PD-së duket se gëzon mbështetjen e të gjitha partive aleate. "Në një situatë të tillë ne jemi të detyruar të rishohim vendimin tonë, sepse është një situatë krize politike dhe kushdo që mundohet të mos e shohë, bën gabim, sepse e thellon në shumë krizën dhe nuk e zgjidh atë. Kështu, në këto moment ne mendojmë që Shqipëria ka nevojë të zgjidhet krizën dhe nuk është shumë i rëndësishëm fati i agrarëve, por është shumë i rëndësishëm zgjidhja e krizës politike dhe si pasojë,



Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka

DEKLARATA

"Nuk ka zgjedhje në Shqipëri pa u larguar Rama dhe pa u krijuar kushtet për zgjedhje të lira. Vendim politik për të hyrë ose jo në zgjedhje nuk ka akoma, por po them që me këtë kryeministër që vazhdon të tregojë me këmbëngulje dhe arrogancë që do të vazhdojë t'i vjedhë votat, ma thoni ju rrugën. Zgjedhje pa kushte nuk do të ketë", - tha Z.Paloka.

Tension tek "Astiri", Basha: Urdhër për arrestimin e banoreve

Një situatë e tensionuar është krijuar mbrëmë tek Unaza e Re, ku banorët e "Astirit" vijnë në protestë. Pranë tyre ka shkuar vetë kryedemokrati Lulzim Basha, i cili në një lidhje direkte me studion e emisionit "Dritare me Rudinën" në "News 24" tha se me urdhër politik policia kish të shkuar sot në zonë për terror dhe për të shoqëruar banorët që protestojnë prej 4 muajsh. "Pushteti ilegjitim i ngritur mbi votën e vjedhur nga bandat po u shërben bandave. Policia kishte marrë urdhër të shoqëronte banorët që kanë 4 muaj që protestojnë për afërën, që Damian Gjinkuri duhet të ishte në burg



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje tek "Astiri"

dhe Edi Rama të merrej i pandehur. Një urdhër politik i ardhur nga nivele të larta, supozohet nga Lleshaj dhe Rama për të kryer akte terrori. Kur bisha

plagoset, bëhet më e rrezikshme. Këta e kanë kuptuar që po iu vjen fundi. Këta kanë dalë nga bandat dhe u shërbejnë bandave", - tha Basha.

arritja e standardeve të zgjedhjeve", deklaroi Z.Paloka.

PROTESTAT

Opozita thërret protestën e radhës ditën e enjte në orën 9:30 përpara parlamentit, gjatë kohës kur ky i fundit do të mbledhet në seancë plenare. Pas përcaktimit nga Konferenca e Kryetarëve të Kuvendit që seanca e radhës të zhvillohet ditën e enjte në

orën 10:00, opozita ka njoftuar vijimin e aksionit të saj për mes protestave, ku e radhës do të jetë pikërisht më 21 mars, përpara godinës së seancave plenare. Kjo do të jetë hera e katërt që mbledhja e deputetëve në seancë parlamentare shoqërohet me protestë të thirrur nga opozita, herë përmes grumbullimit të qytetarëve jashtë ambi-

entit të parlamentit, apo përmes simbolikave të shpalosura gjatë zhvillimit të seancave parlamentare. Deri në uljen e palëve në tryezën e dialogut, protestat janë aksioni i vetëm i opozitës. Të enjten sërish do të jenë jashtë Kuvendit në tubimin e radhës. Opozita do t'u rikthehet protestave para parlamentit për largimin e qever-



Protesta e fundit e opozitës para Kuvendit

Lleshaj përplaslet me studentët e Durrësit: Turp, na ke helmuar me gaz

Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, dje u prit me pritestë nga një grup studentësh dhe të rinjsh mbështetës të opozitës në Universitetin Aleksandër Moisiu të Durrësit. Ky i ri i vetëidentifikuar si Ndreç Pjetri u përball me ministrin Lleshaj, duke i thënë se atij se nuk duhet të vizitojë asnjë vend të Shqipërisë, pasi sipas tij, qeveria është ilegjitime. Ndreç Pjetri u shpreh: "Juve nuk ju takon të shkoni në asnjë vend të Shqipërisë. Ju vini qeveri legjitime. Erdhët këtu dhe ne e morëm vesh vetëm 1 orë përpara, sikur po vjen kreu i shërbimit sekret". Në replik me ministrin, ai la të nënkuptohet se ka qenë pjesë e protestave të opozitës në Tiranë, ku është përdorur gaz lotsjellës, fakt për të cilin nuk munguan pyetjet për ministrin as nga studentë të tjerë. Pjetri vijoi: "Jam qytetar i këtij vendi dhe ju më keni helmuar. Jeni i ministri i Brendshëm dhe na helmuat me gaz. Turp! Po sot çfarë do bëni? Cilat janë masat që do merrni? Do më arrestojnë shoqëruesit tuaj?".

Lirohen 10 protestues të opozitës, 4 mbeten në burg

Gjykata la dje në burg 4 nga protestuesit e 16 marsit, ndërsa 10 të tjerë janë liruar me masën "Detyrim paraqitje". Me masën "Arrest me burg" janë lënë Gazmir Bekshiu, Aldi Spaho, Ermir Bruka dhe Pal Daija. Ndërsa Edisson Tahiri, Klajdi Poci, Denaldo Buzi, Eduard Buzi, Elidjan Buzi, Florian Zeneli, Jeton Spahiu, Ali Bruçi, Kevin Kastriati dhe Flamur Rrahja u lanë me "Detyrim paraqitje". Ndërkohë vijojnë të jenë në kërkim 7 persona, pjesëmarrës në protestë. Një ditë pas protestës së 16 marsit, policia procedoi 33 persona për dhunën e ushtruar në protestën para parlamentit të Shqipërisë, mes të cilëve edhe Sekretari i Partisë Demokratike, Gazmend Bardhi, i cili ka qenë dhe organizatori i protestës. Në protestën e opozitës të së shtunës, përpara parlamentit pati përplasje të dhunshme me policinë dhe protestuesve. Nga radhët e policisë pati 3 efektive të lënduar, si dhe disa protestues.

isë "Rama". Në orët e vona të së hënës, sekretariatit organizativ ka lajmëruar me mesazh të gjitha strukturat, duke iu kërkuar mobilizim që të enjten në orën 9:30 protestuesit të jenë para Kuvendit. Sipas këtij mesazhi, që iu është shpërndarë të gjitha degëve, por edhe strukturave organizative, vendimi për të protestuar të enjten është

marrë të hënën, pasi Lulzim Basha takoi kolegjin e degëve, edhe pse ai vetë pas mbledhjes nuk dha një ditë kur do të protestohet. Krahas protestës para parlamentit, Partia Demokratike do të protestojë edhe në rrethet, ndërkohë që po vlerësohet mundësia e rikthimit sërish në protestë masive para Kryeministrit.



Valentina Madani

Prezenca e OSBE në Shqipëri përmes ambasadorit Bernard Borchardt shprehu dje shqetësimin se djegia e mandateve nga opozita është një hap që i vë flakën të gjithë sistemeve parlamentare. Sipas Borchardt kriza politike në Shqipëri mund të prekë dhe rajonin. Në prezantimin e programit master në fushën e kriminalistikës, ai theksoi se djegia e mandateve nga ana e deputetëve të opozitës nuk minon vetëm sistemin parlamentar. "Është kritikuar nga të gjithë ndërkombëtarët, sepse është fitili që i vë flakën të gjithë sistemeve parlamentare. Për shumë kohë Shqipëria ka qenë shtylla apo simbol i stabilitetit në rajon dhe tani shohim një veprim në parlament që nuk ka precedentë. Është kritikuar nga e gjithë komuniteti ndërkombëtar, sepse ndez fitilin që i vë flakën në të gjithë sistemin e demokracisë parlamentare. Deputetët vendosën pas dy vitesh, dhe jo në katër të djegin mandatet e tyre, herën tjetër do të gjejnë argumente për të marrë një vendim të tillë pas 6 muajsh apo 10 muajsh dhe kjo do të ishte një shembull i keq për të gjithë rajonin. Ju e dini që në shumë shtete ka opozita që bojkotojnë parlamentin dhe një gjë e tillë nuk funksionon, sepse nuk është fare thelbi i demokracisë parlamentare", deklaroi z. Bernd Borchardt.



Berisha bën denoncimin e rëndë: MAS po trafikon të rinjtë

Ish-kryeministri Salii Berisha publikoi dje mesazhin e një qytetari dixhital që thotë se Ministria e Arsimit po trafikon të rinj drejt Anglisë duke i kaluar si sportistë. Sipas denoncuesit, të rinjtë paguajnë nga 7 deri në 11 mijë euro për person. "Denoncohet Ministria e Arsimit për trafik të qenieve njerëzore kundrejt 7-11 mijë euro në Angli!", shprehet z. Berisha. Ish-kryeministri zbardh mesazhin e qytetarit dixhital: "Doktor ju shkruaj nga Anglia. Tmerr dhe skandal më i madh i qeverisë dhe i Ministrisë së Arsimit se si trafikojnë të rinjtë shqiptarë nga mosha 18-25 vjeç. Duke bërë falsifikime dhe duke dërguar të rinjtë shqiptarë si sportistë në Angli dhe duke u marrë nga 7 mijë - 11 mijë euro për person. Dhe i dërgojnë si sportistë. Veç mjafton të hapni sistemin Tims se sa të rinj kanë ikur si sportistë e nuk janë kthyer. Kjo është ndrikulla ministere dhe tash këto gjëra po i bëjnë këta të sportit".

Borchardt: Djegia e mandateve, e paprecedent. Kryemadhi: Jo zgjedhje vendore të deformuara

Përplasja, OSBE: Ndezët fitilin. PD e LSI: Zgjedhjet u blenë

Bylykbashi: 19 kriminelë hynë në parlament



Ambasadori i OSBE-së Bernard Borchardt

DEKLARATAT

BORCHARDT
"Për shumë kohë Shqipëria ka qenë shtylla apo simbol i stabilitetit në rajon dhe tani shohim një veprim në parlament që nuk ka precedent".



BYLYKBASHI
"Të kriminalizohet politikën me paranë e drogës, korrupsionit dhe oligarkisë, të bleh zgjedhjet dhe të kthesh shtetin në parti, ky është shembulli i keq për rajonin".



KRYEMADHI
"S'mund të kesh zgjedhje vendore kur ka deformim dhe shitblerje të votës përmes grupeve kriminale dhe parave të kriminelëve".



i kujtojnë jo vetëm gjetjet në raportin e hartuar nga vetë misioni, por njëherazi edhe dosjet ku sipas opozitës faktotet përshirja e ish-ministrave socialistë në blerje votash. Ish - bashkëkryetari i Reformës Zgjedhore Oerd Bylykbashi, shprehet se shembulli i keq në rajon është mosreagimi ndaj problemeve që kanë të bëjnë me

votën e lirë. "Të fitosh zgjedhjet me bandat e kriminelëve dhe 19 prej tyre t'i bësh deputetë, më pas kriminelët përdhunues vrasës e trafikantë t'i bësh kryetarë bashkish që të kontrollojnë territorin dhe zgjedhjet, ky është shembulli i keq për rajonin. Të mos reagosh, të mos thuash gjysmë fjale për të gjitha këto, të mjaftohesh vetëm me

përmbledhje ekzekutive raportesh dhe të relativizosh problemet e rënda, është një shembull i keq për të gjithë", deklaroi z. Bylykbashi. Kurse kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi nga Shkodra, pas një takimi me qytetarët, u shpreh se është e pamundur të përfshihesh në garë pa garantuar më parë zgjedhjet e lira e të ndershme. "Nuk mund të kesh zgjedhje vendore kur ka një deformim dhe shitblerje të votës përmes grupeve kriminale dhe parave të grupeve kriminale. Zgjedhjet nuk janë gjë tjetër veçse çështje teknike shumë kalimtare. Nëse ne nuk do kemi zgjedhje të lira dhe të ndershme do të jetë totalisht e pamundur", deklaroi z. Kryemadhi. Kryetarja e LSI-së njoftoi se protestat do të vijojnë, jo vetëm në Tiranë, por në të gjithë vendin. "Përveç protestave të mëdha që do të bëjmë në Tiranë do të dalim në çdo qytet të Shqipërisë, të takohemi dhe të bisedojmë me ta për të qarë hallet dhe diskutuar", theksoi z. Kryemadhi.

Zgjedhjet e 30 qershorit, misioni i OSBE/ODIHR takon Bashën e Ballën

Misioni i OSBE/ODIHR zhvilloi dje takime me përfaqësuesit e partive politike për zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Fillimisht dy përfaqësuesit e OSBE-ODIHR Ana Rusi dhe Alexey Gromov ishin në selinë e PS ku takuan kreun e grupit parlamentar Taulant Balla. Më pas në orën 19:00 ata shkuan në selinë e PD-së ku takuan kreun demokrat Lulzim Basha. Misioni i tyre është mbledhja e fakteve në kuadër të zgjedhjeve lokale të 30 qershorit. Lëvizjet e OSBE-ODHIR vijjnë një ditë pasi opozita refuzoi të paraqiste listat e komisionerëve për zgjedhjet vendore, duke paralajmëruar dhe bojkotin e votimeve. Kurse Partia Socialiste iu është përgjigjur thirrjes urgjente të KQZ për dorëzimin e emrave të propozuar për KQZ-të. Edhe Prezenca e OSBE-së



MISIONI

Lëvizjet e OSBE-ODHIR vijjnë një ditë pasi opozita refuzoi të paraqiste listat e komisionerëve për zgjedhjet vendore, duke paralajmëruar dhe bojkotin e votimeve.

iu është bashkuar thirrjes së KQZ-së për dorëzimin e propozimeve për emrat e anëtarëve të KZAZ nga ana e partive politike për zgjedhjet e 30 qershorit. OSBE

shprehu shqetësimin se vonesa në depozitimin e propozimeve, vë në rrezik procesin zgjedhor në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Veliaj shpall kandidaturën: Të vijë Luli dhe Saliu bashkë

Kryebashkiaku Erion Veliaj fton të gjithë qytetarët që të marrin pjesë masivisht me familjet e tyre në takimin "Bashkia që duam" do të ndalet më 23 mars në kryeqytet. Teksa konfirmoi për Top Channel rikandidimin për drejtimin e Bashkisë së Tiranës edhe për 4 vite të tjera, Veliaj siguroi se ky mandat i dytë do të vijë me projekte të reja. "Mezi e pres që të fillojmë këtë mandat të dytë, me projekte të reja, por dhe me gjëra që kemi mësuar si t'i bëjmë më mirë. Të jemi të gjithë të shtunën në Kongresin e PS-së, ku ne do të shpallim në publik, jo në



salla të mbyllura, kandidaturën për një mandat të dytë të Tiranës, si dhe Këshillit Bashkiak të Ti-

përsëritje e Ditës së Verës, në një pranverë të fushatës sonë të dytë", tha Erion Veliaj. Ai sfidon edhe opozitën, e cila nuk ka vendosur ende nëse do të marrë pjesë në zgjedhje apo jo. "Të vijë Luli, Saliu...të dy bashkë! Të vijë kush të dojë. Por, rëndësi ka të kemi një pjesëmarrje. Qoftë dhe ajo pakicë që e voton ende PD-në, të ketë edhe ajo përfaqësuesit e vet në Këshillin Bashkiak. Sepse unë besoj që gjithmonë duhet një mendim alternativ", tha Erion Veliaj.

Nano pranon ftesën, Peza: PS do shkojë në zgjedhje me apo pa PD

Ish-kryetari i Partisë Socialiste, Fatos Nano e ka pranuar ftesën për të qenë i pranishëm në kongresin e kësaj force që mbahet të shtunën. Lajmin e ka konfirmuar sekretari socialist, Alfred Peza duke folur në "A2". Ndërkohë duke folur për kongresin e 23 marsit, Peza tha se kongresi është i parashikuar muaj më parë dhe është një kongres elektoral. "PS vazhdon axhendën politike të vendosur muaj më parë, pa ditur se çdo të ndodhte sot. PS do të shkojë në zgjedhje, me apo pa PD. Axhendën nuk e dikton dot asnjë nga partitë politike, por vullneti i popullit shqiptar. Strukturat e PS do të përfaqësojnë edhe nëse Dako apo Sejdiqi do të jenë sërish kandidatë për kryetarë bashkie", tha ai.



Me 3 emrat e rinj numri i deputetëve të opozitës në Kuvend arrin në 16

KQZ u jep mandatin 3 kandidatëve të LSI, Kuvendi shkon në 95 deputetë

Gjoni, Musai dhe Koçiraj, të zgjedhurit e rinj

Arrin në 95 numri i deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë. Pas 10 deputetëve të parë që morën mandatin e dorëzuar nga deputetët e opozitës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të plotësojë edhe 3 vakanca të tjera duke e çuar në 16 numrin e deputetëve "opozitarë" në Kuvend. Bëhet fjalë për 3 kandidatë që vijnë sërish nga listat shumëemërore të Lëvizjes Socialiste për Integritim. Dhe më konkretisht Ralf Gjoni që merr mandatin e deputetit në Qarkun e Tiranës duke zëvendësuar Klajda Gjoshën, Nimet Musai që merr mandatin e Petrit Vasilit në Qarkun Fier dhe Enada Koçiraj që zëvendëson Shezai Rrokajn në Qarkun e Vlorës. Të tre këta kandidatë kanë dorëzuar tashmë formularin e deklarimit të pasurive dhe gjatë mbledhjes së sotme KQZ priten të bëjnë procedurën formale të kalimit të mandatin të deputetit. Ralf Gjoni e ka deklaruar edhe publikisht që do ta merrte mandatin, pasi sipas tij kështu i shërbente të ardhmes së vendit. Ndërkohë që dje ka reaguar edhe kandidati tjetër që merr mandatin e deputetit Nimet Musai. Ai dorëzoi mandatin e këshilltarit në Këshillin Bashkia të Fierit për të marrë mandatin e deputetit. "Në Kuvend do punoj për të mirën e qytetit të Fierit dhe do jap kontributin tim për gjithçka që meriton vendi", tha dje Musai. Ndërkohë që kandidata tjetër e LSI që merr mandatin e deputetit është Enada Koçiraj. Ajo ka qenë e tretë në listën e Qarkut Vlorë dhe zëvendësojë ish-deputetin Shezai Rrokaj. Ajo është vetëm 25 vjeç dhe deri më sot ka qenë kryetare e LRI-së për Vlorën. Ndërkohë që nga 13 de-

putetët e rinj që kanë pranuar të marrin mandatin e deputetit 10 prej tyre janë nga

LSI dhe vetëm 3 nga PD. Gjithsesi burime nga KQZ bëjnë me dije se për momen-

tin nuk ka kandidatë të tjerë që kanë pranuar të marrin mandatin e deputetit. Kjo për faktin se nuk janë shpallur mosmarrja e mandatin nga një numër i konsiderueshëm kandidatë që kanë refuzuar të futen në Kuvend dhe se në një pjesë të qarqeve listat kanë filluar të shterojnë. Gjatë mbledhjes së sotme të KQZ-së priten të miratohen edhe vendimet për mospranimin e mandatin nga 18 kandidatë të tjerë të PD dhe LSI. Mes tyre janë edhe emra të njohur si Preç Zogaj, Dashamir Tahiri apo edhe Agron Duka. Në rendin e ditës së KQZ-së janë edhe projektvendimet për regjistrimin e katër partive të reja për zgjedhjet vendore të 30 qershorit. "Partia Personat me Aftësi të Kufizuar", "Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë", "Partia e të Drejtave të Mohuara" dhe "Partia Lëvizja Punëtorë Shqiptare", këto janë katër partitë, të cilat priten të regjistrohen nesër nga KQZ. Këto nuk janë partitë e para që regjistrohen si subjekte zgjedhore për zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Para tyre KQZ ka regjistruar edhe disa partitë tjera që janë aleatë të PS-së. Gjithsesi partitë politike kanë ende edhe afro 1 muaj afat për t'u regjistruar si subjekte zgjedhore. Deri atëherë duhet t'i jetë dhënë edhe zgjidhje krizës politike, në mënyrë që opozita të regjistrohet në zgjedhje.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

ZGJEDHJET

"Partia Personat me Aftësi të Kufizuar", "Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë", "Partia e të Drejtave të Mohuara" dhe "Partia Lëvizja Punëtorë Shqiptare", këto janë katër partitë, të cilat priten të regjistrohen nesër nga KQZ.

KANDIDATET

Ralf Gjoni që merr mandatin e deputetit në Qarkun e Tiranës duke zëvendësuar Klajda Gjoshën, Nimet Musai që merr mandatin e Petrit Vasilit në Qarkun Fier dhe Enada Koçiraj që zëvendëson Shezai Rrokajn në Qarkun e Vlorës.



Pranoi mandatin e PD-së, kërcënohet deputeti Ligoraq Karamelo

Deputeti i ri i PD-së, Ligoraq Karamelo është kërcënuar nga tre persona. Ngjarja ka ndodhur në Korçë dhe këtë e pranoi edhe vetë Karamelo për median. "Tentuan të më godisnin, në momentin që unë sapo dilja nga lokali, ishin tre persona. Më quajtën tradhtar", - kështu ka deklaruar Karamelo për median. Ai ka theksuar se nuk do të tërhiqet nga vendimi i tij për të qenë pjesë e parlamentit, pavarësisht se opozita kërkon që të dëgjim mandatin e deputetit. "Nuk tërhiqem nga mandati im, nuk i nënshtrohem presioneve". Mësohet se Karamelo ka bërë denoncimin në organet e policisë dhe vetë ai bën të ditur se një person është shpërndarë nga policia. Ligoraq Karamelo është përfaqësues i PBDNJ-së, kryetar i shoqatës "Omonia" në Korçë. Ai u fut në listën shumëemërore të kandidatëve të PD-së si pjesë e marrëveshjes politike me PBDNJ-në. Pas dorëzimit të mandateve të deputetëve të opozitës, Karamelo refuzoi të zbatonte urdhrin e partisë së tij për të marrë mandatin e deputetit.

DEKLARATA

"Më quajtën tradhtar, - kështu ka deklaruar Karamelo për median. "Nuk tërhiqem nga mandati im, nuk u nënshtrohem presioneve", - tha Karamelo për median.

Kreu i Komisionit të Ekonomisë: Konkurrenca të nisë hetim, paguajnë qytetarët

Dominimi i tregut, Ahmetaj: 200 mln euro dëm për biletat e avionëve

Bllokohet liberalizimi, kolaudimi i automjeteve mbetet monopol

Komisioni parlamentar i Ekonomisë dhe Financave i ka kërkuar Autoritetit të Konkurrencës të nisë hetimet për disa tregje, të cilat po abuzojnë në kurriz të konsumatorëve, duke e vënë theksin tek ai i fluturimeve ajrore dhe medikamenteve. Kreu i komisionit, Arben Ahmetaj, bëri me dije se fatura që paguajnë qytetarët shqiptarë për biletat e shtrenjta është rreth 200 milionë euro, për shkak të dominimit të dy linjave ajrore. "Si ka mundësi që çmimet e biletave janë shumë të shtrenjta për linja të ngjashme si psh., brenda Italisë apo brenda Austrisë është dy herë më i lartë. Dëmi i konsumatorit shqiptar mund të shkojë deri në 200 milionë euro. Çfarë bëjmë ne, çfarë bën Autoriteti, çfarë bën administrata etj.?", - tha Ahmetaj. Një treg tjetër ku kërkoi sërish më shumë vëmendje është edhe ai i kolaudimit, koncesion të cilin Arben Ahmetaj e cilësoi turp. Por, kryetarja e Komisionit të Konkurrencës, Juliana Latifi, theksoi se ky institucion nuk ka bashkëpunimin e nevojshëm me qeverinë dhe se rekomandimet e lëna për tregjet ku janë konstatuar abuzime nuk janë vënë në zbatim.



Kreu i Komisionit të Ekonomisë, Arben Ahmetaj

na nga Autoriteti i Konkurrencës përsa i përket kolaudimit të automjeteve. Gjatë raportimit vjetor në Komisionin e Ekonomisë, kryetarja e këtij institucioni deklaroi se ministria nuk ka marrë parasysh asnjë rekomandim

mbi liberalizimin e tregut. "Këto rekomandime nuk janë përmbushur. Në rastin e Ministrisë së Energjetikës. Kemi

2.5

MILIONË EURO
Vitin e kaluar Autoriteti i Konkurrencës arkëtoi 2.5 milionë euro nga gjokat e vendosura mbi bizneset që shkelin konkurrencën në treg.

kërkuar si në rastin e koncesionit të SGS-së, kemi dhënë një sërë rekomandimesh për përmirësimin e kuadrit ligjor, që u adresohen akteve ligjore apo nënligjore përkatëse, të cilat nuk janë marrë në konsideratë. Autoriteti i Konkurrencës i ka përsëritur shkresat kundrejt institucioneve përkatëse", - tha Juliana Latifi. Madje, edhe kryetari i Komisionit të Ekonomisë, Arben Ahmetaj, është shprehur i shqetësuar për mungesën e reagimit. "Koncesioni i kolaudimit të makinave është turp, turp! Ju kemi marrë një qëndrim, qëndrim i drejtë. Keni vendosur një gjokë, gjokë e drejtë. Praktika ka ndryshuar", - deklaroi Ahmetaj. Në total gjatë 2018, Autoriteti i Konkurrencës ka vendosur gjoka që arrijnë në 269 mln lekë ndaj kompanive që kanë shkelur konkurrencën.



Tatimet: Gjokat variojnë deri në 1 mln lekë për bizneset

Kundravatja në lëshimin e faturave dhe dëftesave tatimore nga tatimpaguesit ndëshkohet me gjokë. Paralajmërimi ka ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila ka publikuar informacionin e nevojshëm në rubrikën "Tatimet këshillojnë", si dhe masën e gjokës për tatimpaguesin, por edhe konsumatorin në rastin e mosmarrjes së kuponit tatimor. Kështu, sipas DPT-së, moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjokë të barabartë me 100% të tatimit të padeklaruar. Ndërkohë, në rastet kur tatimpaguesit kryejnë shkelje të përsëritur, Tatimet parashikojnë edhe marrjen e masave të tjera. Më konkretisht: Ndërkohë, sipas DPT-së në rastet të mospërmbushjes së detyrimit për lëshimin e dokumenteve tatimore, tatimpaguesit i logaritet TVSH-ja në masën që ky mall do të tregohet me pakicë për konsumatorin final. Njëkohësisht gjobiten në masën 100% të vlerës së TVSH-së të logaritit, që i përket vlerës së shitjeve që tejkalojnë kufirin e lejuar për shitjet me kupon tatimor. Sa i takon mosmarrjes së kuponit tatimor, blerësi dënohet me 1000 lekë gjokë, nëse kapet në një distancë jo më shumë se 30 metra nga vendi i daljes së dyqanit. Kurse tatimpaguesit që pengojnë ushtrimin e kontrollit apo hetimin tatimor dënohen me gjokë prej 100 000 lekë për biznesin e vogël dhe 1 000 000 lekë për bizneset e reja. Në rastet kur organet tatimore konstatojnë fshehtësi të informacioneve për gjendjen ekonomike-financiare të tatimpaguesve kanë të drejtë të sekuestrojnë dokumentacionin tatimor, pajisjet kompjuterike e fiskale si dhe mjete të tjera që kanë të bëjnë me të ardhurat, shpenzimet etj.

Tapia për tokën me ligjin 7501

Titujt e pronësisë dhe plotësimi i dokumenteve, ndryshon afati



Procesi i verifikimit të titujve të pronësisë do të zgjasë deri në fund të këtij viti. Vendimi i publikuar në Fletoren Zyrtare parashikon se verifikimi i titujve të tokave bujqësore së bashku me afatin e plotësimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi përfundon me 31 dhjetor 2019. Në fillim të muajit prill pritet që të hyjnë në fuqi ndryshimet e bëra në ligjin "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfutuesve", i ndryshuar. Tashmë i publikuar në Fletoren Zyrtare, ligji me ndryshimet e bëra së fundmi rrëzon kriterin e vendbanimit të detyrueshëm të atyre që kanë përfituar tokën bujqësore, çka do të thotë që ata jo domosdoshmërisht duhet të jenë ende banorë të së njëjtës njësi vendore. Kështu, në nenin 2 të ligjit, qeveria ka shfuqizuar pikën "ii", e cila theksonte se ligji zbatohet për subjektet që përmbushin disa kushte,

mes të cilave në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji të jenë banorë të njësisë së qeverisjes vendore dhe prej datës 1.10.1992 nuk kanë ndryshuar vendbanimin e tyre sipas regjistrit të gjendjes civile. Nga ana tjetër, ligji shton kategoritë e atyre që përfitojnë përmes dy pikave të reja. Ky ligj do të zbatohet për familjet bujqësore ose individët, të cilët përmbushin kushtin e parë

duke qenë punonjës të ish-ndërmarrjes bujqësore më 1.8.1991, gjendja civile e të cilëve u është transferuar në fshatin ku gjendet toka objekti i kalimit në pronësi, pas datës 1.8.1991, por të mos kenë përfituar tokë bujqësore në përdorim apo pronësi, i) e përdorin tokën për veprimtari bujqësore, por kanë mungesa në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit apo pronësisë". I njëjti ligj ka përshirë edhe kategoritë e pronave që përjashtohen nga procesi i kalimit të titujve, duke shtuar se nuk do të vijohet me këtë pjesë për atë pronë që janë objekt i investimeve strategjike sipas ligjeve në fuqi.

mungesa në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit apo pronësisë. Përfutës sipas pikës së katërt që shtohet në nenin 2 janë familjet bujqësore ose individët, të cilët përmbushin kushtet si më poshtë: i) nuk kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjeve bujqësore, por kanë qenë banor? të fshatit ku gjendet toka bujqësore, objekti i kalimit të pronësisë, sipas regjistrit të gjendjes civile më 1.8.1991, por të mos kenë përfituar tokë bujqësore në përdorim apo pronësi; ii) e përdorin tokën për veprimtari bujqësore, por kanë mungesa në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit apo pronësisë". I njëjti ligj ka përshirë edhe kategoritë e pronave që përjashtohen nga procesi i kalimit të titujve, duke shtuar se nuk do të vijohet me këtë pjesë për atë pronë që janë objekt i investimeve strategjike sipas ligjeve në fuqi.

Njoftim shitje me ankand

Shoqëria përmbarimore "AA Bailiff" shpk, zhvillon ankandin e II-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Truall 310 m2 dhe ndërtesë 96 m2, me nr. pasurije 170/14, Vol. 8, Fq. 154, ZK. 3852, në pronësi të Ruzhdi Demir Tropolini e regjistruar ne ZVRPP Durrës. Çmimi i ankandit të ditye është EUR 24.000 (njëzetë e katër mijë euro).

Ankandi i zhvillohet dt. 08/04/2019, ora 16.00 në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Kati i III-të, Tiranë.

Njoftim për shitje me ankand

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur ankandin e trette të pasurisë të palës debitore Sh "ARNI" sh.p.k dhe hipotekuesve P Goxhaj dhe M Goxhaj, Pasuria që deti ne ankand te trette përbehet nga :

"Apartamenti" me Nr pasurie 69/11/ND-1-14/ndodhur ne Rr "Dodona", Hyrja nr.1, Kati i 3 Ap 14, Orikum e regjistruar ne ZVRPP-Vlora, ZK Nr.2832, volumi 16, faqe 12b, Ankandi i pasurisë fillon me ciminin fillestar në masën 1.209.600 lekë Ankandi do të zhvillohet në datë 10.04.2019 në orën 15:00 në selinë Bul "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5. Kontakt 067 2082543 e-mail lirr_dervishi@yahoo.com faqen WEB www.powerjustice-ai.com

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përmbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përmbarese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e ditye për pasurine : 1- Truall, me sipërfaqe 250 m2 dhe sipërfaqe ndërtesë 85m2 e ndodhur në Bitnckë, Devoli, në Zonën Kadastrale 1202, Numri i Pasurisë: 1831/50, Vol. 20, Faqe 70, në pronësi të Vasil Frati Musku. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 5.600 (peshmje e gjashtëqind) EURO ose 700.000 (shtatëqind mijë) LEKE.

Ankandi i ditye për pasurine e mesiperme zhvillohet me datë 17.04.2019 , ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përmbarese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr."Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 069381883 .

Përplasja me familjarët e autorëve, vendimi jepet më 26 mars

Tension në gjyqin për vrasjen e Marvi Mihalit, babai i 22-vjeçarit: Drejtësi, ose Kanun!

TIRANË - Me debate është zhvilluar edhe ditën e djeshme seanca gjyqësore për vrasjen e Marvi Mihalit. Familjarët e të pandehurve pretendojnë se familja Mihali ka kërkuar dëshmësi për jetën e të birit. Prindërit e 22-vjeçarit të ndërjerë e kanë kundërshtuar këtë pretendim. Trupa gjyqësore urdhëroi që Mira Mihali të dilte jashtë, për shkak se kishte thyer solemnitetin e gjykimit. Jashtë sallës së gjyqit, Pavullo dhe Mira Mihali deklaruan se nuk bëjnë pazar me gjakun e të birit dhe se kërkojnë të bëhet drejtësi. Ata akuzojnë gjyqtarët se janë blerë e nuk po bëhet drejtësi. Nëna e Marvi Mihalit tha se janë shpifje të gjitha deklaratat se kanë

bërë padi civile për dëshmësi, duke thënë se dhimbjen që ajo po provon përditë për djalin e tretur në dhe, duhet ta provojnë edhe prindërit e autorëve. Babai i viktimës u shpreh jashtë ambienteve të gjykatës se nëse nuk bëhet drejtësi, do të funksionojë Kanuni ose Kurani. "Në mënyrën më absolute nuk kemi kërkuar asnjë lloj dëshmësi. Nuk mundet kurrë të lajë gjakun e djalit tim me lekë. Këto janë shpifjet e asaj familje kriminale. Familje që ka pjellë kriminelë. Unë do t'i them:

Deri tani është bërë diversion i hapur kundrejt Marvi Mihalit. Duke filluar që nga familjarët, që nga kriminelët që ma vranë, 4 kriminelë, e deri tek avokatët, deri te prokurori Artan Lulaj, i cili fatkeqësisht akoma ndodhet në sistemin e drejtësisë. Ky diversion i hapur do t'i japë fund njëherë e përgjithmonë, e gjithë drejtësia tani ndodhet në dorën e trupit gjyqësor. Ju them këtyre gjyqtarëve: Dëmi që i bën një shoqërie 100 kriminelë është shumë herë më i vogël se sa dëmi i një gjykimi të padrejtë që mund

t'i bëhet djalit tim. Për këto unë kërkoj drejtësi. Në momentin që nuk do bëhet drejtësi, në qoftë se nuk do bëhet drejtësi, atëherë le të funksionojë ligji i Kuranit dhe ligji i Kanunit. Unë do të flijohem. Sepse kam përballë kriminelë, kam përballë baballarët e kriminelëve duke më prekur, duke më hedhur vështrime. Nuk kanë lënë gjë pa bërë dhe tani vazhdon ngrihet atje dhe gënjen e shpif. Djali im po trettet në dhe. Ia thershin djalin me thika atje në burg. Ia derdhsin gjakun atje dhe ta



kem frymë. Boll i kam duruar baballarët e kriminelëve duke më prekur, duke më hedhur vështrime. Nuk kanë lënë gjë pa bërë dhe tani vazhdon ngrihet atje dhe gënjen e shpif. Djali im po trettet në dhe. Ia thershin djalin me thika atje në burg. Ia derdhsin gjakun atje dhe ta

shikojë. Nuk bëjnë dot pazarë. Ka çmim për gjakun e fëmijëve të tyre? A ka çmim? E provoshin në kurrizin e vet dhimbjen e madhe që po provoj unë çdo ditë që po kalon". Këtë të martë ishte mbrojtja që paraqiti argumentet e saj. Në seancën e datës 26 mars pritet shpallja e vendimit.

"O prefekt, ti mua s'më ke asnjë lekë, unë kam hallin tan me heq njerëzit mar"

SHKODËR

Pak ditë pas shkatërrimit të grupit kriminal që jepte fajde, gazeta "Si" botoi pjesën e parë të përgjimeve, që çuan në prangimin e grupit të Shkodrës. Gjithçka ka nisur kur ish-prefekti i Shkodrës, Paulin Radovani, u detyrua të shkojë në dyert e policisë, atëherë kur çdo ditë borxhdhënësi i vinte në biznesin e tij dhe i kërkonte shumat e dhëna dy djemve të tij, Robertit dhe Eltonit. Mandej, i gjithë procesi rrjedh mes përgjimeve dhe vëzhgimeve ambientale. Përgjimet kanë zgjatur dy muaj dhe nga janari, Paulin Radovani ka pasur dhjetëra vizita në oborrin e fabrikës të personave që kërkonin kthimin e borxheve, të cilët shpesh flisnin për përgjindje e shpesh e kërcënonin. Mes të hetuarve është edhe ish-drejtori i Transporteve, Ilir Sokoli, shok me dy djemtë e Paulin Radovani. 31-vjeçari Sokoli shfaqet në një përgjim ambiental nën shoqërinë e të vëllait dhe kërkon shumat e dhëna me fajde. Të njëjtën gjë bëjnë edhe vëllai. Prokuroria thotë se disponon filmime, ndërsa në një moment Iliri i thotë ish-prefektit Radovani: "Na ke marrë në qafë, na ke varrosur të gjithëve".

PËRGJIMI AMBIENTAL VAZHDON SI MË POSHTË

Vladimir Sokoli: Iliri ka marrë lekët e mia dhe ua ka dhënë. Ato janë kursimet e mia. Të Paulin ke bërë lëvizje taktike, i ke dërguar fëmijët jashtë, por fol me djalin të të tregoj se ku e ka futur Ilirin.

Paulin Radovani: Kam dërguar njerëz për ta shtritur fabrikën dhe të laj borxhet, por nuk njoh kush janë borxhlijtë. Sa kohë ke që u jep lekë fëmijëve të mi, se më keni thënë për një Prek Hoxha që ai rri në Malsi të Madhe dhe nuk del. Prokuroria m'i ka bilokuar pronat, nuk i shes dot.

Ilir Sokoli: Unë 70.000 ia kam Ed Memçës se nuk ua jepte djemve të tu, as Bertit

Përgjimet për grupin e fajdeve në Shkodër: Ti gjej djemtë për 24 orë dhe t'i vras

Ilir Sokoli, ish-prefektit Paulin Radovani: Na ke marrë në qafë, na ke varrosur të gjithëve

dhe as Tonin. Hina unë garant. Kemi lekë edhe në Dobrac se kena shku i kena marrë me Tonin, të dy ata e dinë si unë. O prefekt 1000 mijë dollarë e euro me të lutj, qatë thotë Ilir Sokoli e ca përmend me emra e me fiks, domethënë ti mua s'më ke asnjë lekë, unë kam hallin tan me heq njerëzit mar.

Vladimir Sokoli: Nëse ti merrësh me këto kërcënime, do futet shteti e do futet kjo, dëgjo se fjalët e tepërta janë fukarallëk. Në qoftë se ti ke plan me ju thanë atyre të tjerëve se janë më trima, zotni në qoftë se këtij i preket një qime floku, si kemi bo muhabet bashkë... im vëlla Iliri ka ndejt më shumë me fëmijët e tu sesa me mu... Gjej lekët e rregulloje këtë punë.. ose çoje edhe Ilirin të djemtë e tu. Ke bërë gabim që i largove djemtë e na le me kaq shumë probleme se vijnë e të vrasin Ramazanet, na vrasin e ti vrasin Memçajt... i kishte majt byllur. Nëse merrësh me denoncime unë ti gjej djemtë për 24 orë, se njerëzit vrasin aty ku të dhemb më shumë e Paulin.

Prokuroria thotë se Dragani është përfshirë gjithashtu në skemën e pastrimit të parave, përdorishte ka sjellë lekë nga Luksemburgu dhe nuk dihet burimi i tyre.

Në një përgjim tjetër zbulohet edhe roli i të dyshuarit Dritan Kalaja, i cili kërkon



Ish-prefekti i Shkodrës, Paulin Radovani

lekët e tij. Megjithatë Iliri pretendon se kishte hyrë garant të një person tjetër që iu kishte dhënë lekë me fajde djemve të Radovani, emri i tij del si fajdexhi gjatë një përgjimi me një person tjetër. Kësaj radhe ish-prefektit e takon në fabrikë Artan Dragani, edhe ky i kërkon lekët borxh, herë 400 që nënkuptohen 400 mijë euro e herë 700. Shuma kërkohet në emër të një personi tjetër, i cili sipë del nga biseda, i kishte marrë edhe një tokë Radovani, një tokë në Velipojë. Ky person përmendet me emrin "Lilo" dhe prokuroria interpreton se ai është shtetasi Ilir Sokoli.

Radovani shfaqet i habitur, pasi sipas tij, ai ishte shok me dy djemtë e tij, por Artan shton: "Lilo dhe Astrit Sali ka 12 vjet që ju jep lekë me fajde fëmijëve të tu". Radovani shton se Lilo i ka futur fëmijët e tij edhe në një lojë tjetër dhe i kanë marrë 125 mijë euro.

Dragani: "Duke parë letrat, zbulova se edhe ty të kam borxh. Sa të kam borxh

dhe sa të kam fajde? Artan Dragani: Të sqarohem Tani ty, unë Tonit i kam dhënë 110... 10 njëherë tek... 100 njëherë dhe 15 kam çuar Fatmir Bërricën me ia marrë. Paulin Radovani: Unë di që është bërë muhabet për një 5 ce... Dragani: 15... jo pesë. Radovani: Stop njëherë... sa janë? Dragani: Borxh janë 175 mijë euro pa fajde... tashti 65 janë marrë në Luksemburg. I kam marrë me duart e mia, ia kam prurë 65 mijë euro. Dhe 100 mijë euro lekë 'cash' pa fajde. Fajde janë 40 mijë euro. Radovani: E sa është përgjindja? Dragani: Me pesë për qind. Ia ka vu të Toni fajde asnjë ditë. Nëntë muaj janë marrë lekët s'i kena dhënë fajde kurrkujt. Janë 175 mijë euro plus 45 mijë euro që shkojnë në 220 mijë euro.

Dritan Kalaja: Kam dy vjet që më ka dalë goja mbrapa. Kam hyrë për t'i bërë nder Bertit dhe lekët m'i ka marrë Bertit. Mora kredin për dy vjet, 200 mijë euro në 2015 dhe e kam lenë kolateral ndërtesën teme. Bisedat i kam bërë me dy djemtë e tu. Lashë ndërtesën peng. Vepërimit i kanë bërë ata. Lekët s'i kam parë fare. Kredia dhe lekët janë në emrin tim. Kam marrë borxh për t'i larë.

Më tej, Radovani e pyet Draganin: "Duke parë letrat, zbulova se edhe ty të kam borxh. Sa të kam borxh

SHKURT

Kryeprokuroria Marku: Ka kriminalitet të lartë e ngjarje të pazbardhura

VLORE - Kryeprokuroria e përgjithshme e përkoishme, Arta Marku ishte ditën e djeshme në Vlorë, në analizën vajtores të prokurorisë së këtij rrethi. Ajo pohoi se qyteti bregdetar është një zonë me kriminalitet të lartë, ndërsa apeloji për një bashkëpunim të thellë mes organeve ligjzbatuese, me qëllim zbulimin e ngjarjeve që janë ende 'enigmë' për drejtësinë shqiptare. Ndërkaq, gjatë takimit të djeshëm, Marku përcolli një mesazh të fortë për gjyqtarët dhe prokurorët, teksa shtoi se çdokush duhet të mbajë mbi supe kostumet e dështimit. Ajo u shpreh se "togat e zeza" duhet të vijojnë me përkushtim dhe vendosmëri, duke mos u intimiduar nga askush në çështjet që kanë në proces hetimi e gjykimin.

"Sherr me armë mes 2 biznesmenësh, 3

të plagosur në Tiranë"

Ish-kryeministri Sali Berisha ka publikuar mesazhin e qytetarit dixhital, i cili akuzon Policinë e Shtetit se ka fshehur një plagosje të trefishtë me armë zjarri në Tiranë. Sipas denoncimit të publikuar nga Berisha, ngjarja fillimisht është shënuar mes dy biznesmenësh dhe për pasojë kanë mbetur tre shtetas të plagosur. "Narkopolicia fsheh krimin! Lexoni mesazhin e qytetarit dixhital. S'b, prsh. Doktor! Ju bëj me dije për një ngjarje të rëndë që ka ndodhur para tri ditësh në Tiranë, në rrugën 'Bab Rexha', dy biznesmenë ndërtesën njëri nga Tepele-na dhe tjetri nga Burreli. Në konfliktin mes tyre janë plagosur tre persona me armë zjarri dhe policia nuk jep asnjë informacion për ngjarjen mbahet sekret, kjo është policia e narkoshetit!", shkruan Berisha.

Vrasja e tregtarit durrsak në 2017-ën, Kurti i kërkoi ndjesë gruas së viktimës



DURRËS

Vrasja në atentat e ish-menaxherit të VIP-ve, Jurgen Kurti ka alarmuar policinë, e cila pas ngjarjes së rëndë ka shoqëruar familjarët e tregtarit të vrasur, Agim Arapi. Ngjarje kjo e ndodhur në Durrës, në prill të vitit 2017, për të cilën është akuzuar Jurgen Kurti, vjehtëri i tij dhe vëllai i vjehtërit. Pas ekzekutimit të 26-vjeçarit, policia ka shkuar për kontroll në shëpëtinë e bashkëshortes të tregtarit, Vjollca Arapi. Në një intervistë për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare", ajo u shpreh se nuk ka lidhje me vrasjen e të riut dhe se i vjen keq për nënën e Jurgenit. Arapi shprehu keqardhjen e saj për këtë ngjarje, ndërsa u shpreh se ka kërkuar vendosjen e drejtësisë e jo vrasjen e tij. "Dëgjoja në media për vrasjen. Më erdhi keq se ishte djalë i ri. Keqardhje për nënën e tij që i iku djali dhe i them se unë dhe familja ime s'kemi lidhje me atë ngjarje. Unë kam kërkuar burgun, drejtësinë, jo vdekjen e tij. Prokuroria e Tiranës erdhi dhe bëri kontroll. Me morën në pyetje, por unë nuk di gjë për vrasjen dhe 3 fëmijët e mi jetojnë në Itali. Drejtësia nuk u vu në vend për bashkëshortin tim, sepse u ble me para", tha gruaja e tregtarit të vrasur. Ndërsa pohoi se, "i kërkoi burgun, por nuk i kërkoi vdekjen. Vdekjen e atij nuk e kam dashur. Më dhimbset se vdeka është shumë e hidhur. Ndodhën si ndodhën punët, mua nuk ma kthen asnjëri burrin. Unë doja drejtësi, unë nuk doja vdekje. Kur kërkova drejtësi, nuk mu dha. Ndodhi drejtësia e Zotit, por jo e robit. Për njerëzit, për gjyqtarët, për prokurorët. Unë nuk kam parë drejtësi, kam pasur vetëm dhimbje, atë që kam përjetuar, unë nuk e ka përjetuar njeri".

Ekzekutimi i Jurgen Kurtit, flet Vjollca Arapi: Nuk kemi lidhje me ngjarjen, keqardhje për nënën e tij

"Unë doja drejtësi, doja burgun e jo vdekjen e djalit. Ndodhi drejtësia e Zotit, por jo e robit"



Vjollca Arapi, bashkëshortja e tregtarit të vrasur në Durrës



Viktima Jurgen Kurti

vjeç, drejtësia e nxori të pafajshëm. Për shumë muaj zhurma vazhdoi dhe gruaja e viktimës akuzonte vazhdimisht Jurgenin në prononcime në media si autor të vrasjes së burrit të saj dhe kërkonte drejtësi. Por, më 19 prill 2017, vetëm 8 ditë pas ngjarjes, Jurgeni foli për "News 24" me stafin e emisionit "Me zemër të hapur". Ai refuzoi përballjen me Vjollca Arapin, gruan e viktimës, por i kërkoi ndjesë për gjithçka ka ndodhur. "Kërkoj ndjesë për mungesën, ndjesën time për cilinani ju zonjë Vjollca. Hetimi po vazhdon, detyrën për ta zbardhur fatkeqësinë ia lëmë në dorë drejtësisë", tha Kurti. I menjëhershëm

KUSH ISHTE JURGEN KURTI
TIRANË - 26-vjeçari që humbi jetën mbrëmjen e së hënës ishte një emër i njohur në Tiranë dhe në Durrës. Në fillimet e karrierës së tij, Jurgeni u mor me organizimin e eventeve, apo me menaxhimin e artistëve, për të kaluar në pas si biznesmen i mirëfilltë. Në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Jurgen Kurti figuron pronar i tri bizneseve dhe në njërin prej tyre ka bërë ortak edhe kunatin, vëllain e të fejuarës së tij, Kostandin Ekonomin. Edhe pse në një moshë të re Kurti figuron si pronar i bizneseve të ndryshme si bar e restorante, hapje të agjencive të ndryshme si doganore, transporti e turistike. Veprimtari turistike, si hoteleri e ambiente të

reja turizmi. Ndërtime urbane, objekte të ndryshme, ura e objekte civile, servise makinash. Ai merrej me organizimin e panairëve, ekspozitave e tregjeve të organizuara të shitjeve e blerjeve të pasurive të paluajtshme. Jurgen Kurti bënte një jetesë luksoze me makina të shtrenjta dhe pushime të shpeshta jashtë vendit, të cilën jo pak herë e reflektonte me postime në "Instagram". Në postimet e tij në rrjetet sociale, Kurti tregonte momente nga lidhja me të fejuarën e tij, por edhe me nënën. Nga komentet e miqve në fotot e çfilit duket se ata po planifikonin edhe martesën e tyre.

një njeri këtu? Por more makinën e ike...", do të deklaronte bashkëshortja e viktimës atëherë. Sot Vjollca thotë se nuk donte vdekjen e tij, por drejtësi për të shoqin dhe se ajo dhe fëmijët e saj nuk kanë lidhje me vrasjen e Jurgenit. Rreth 2 vjet nga ngjarja e Durrësit, 3 vjet nga vrasja e babait, Jurgen Kurti u ekzekutua në pritë. Nuk dihet se cili ishte mëkati që i mori jetën, por policia dyshon për hakmarrje nisur edhe nga precedentet e mëparshëm. Me gjithë hetimet, deri tani nuk dihet pothuajse asgjë për autorin apo autorët e vrasjes së tij. Ajo që dihet është rezultati tragjik, një 26-vjeçar i vrasur.

ishte reagimi në studion e emisionit "Me zemër të hapur" i Vjollca Arapit, e cila e ftoi të paraqitej në

gojnë kamerat. Pse nuk more policinë Jurgen, kur Gimi ishte në tokë? Pse nuk e more të thoshe po vdes

Shoqërohen dhe merren në pyetje 25 persona për ngjarjen

Atentati ndaj Jurgen Kurtit, policia: U qëllua nga 2 persona të maskuar, dyshohet për hakmarrje

TIRANË - Ekzekutimi i biznesmit Jurgen Kurti ka tronditur mbrëmjen e së hënës kryeqytetin. Një ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në rrugën "Zef Jubani", pranë stadiumit "Selman Stërmasi", policia ka zbardhur detaje të reja për atentatin. Mësohet se në vendin ku u vra 26-vjeçari, blutë kishte gjetur dhe sekuestruar 23 gëzhoja plumbash. Dyshohet se kanë qenë dy persona të maskuar, që i kanë bërë pritë Kurtit pranë banesës së tij. Si pas hetuesve të çështjes, atentatorët e kanë qëllu-

ar të riun nga një makinë tip "Benz E Class" ngjyrë gri, duke i shkakuar vdekjen e menjëhershme. Ndërkaj, në lidhje me këtë ngjarje, policia ka shoqëruar dhe ka marrë në pyetje 25 persona. Pas kryerjes së hetimeve paraprake, burime pranë grupit hetimor deklaruan se pista kryesore e hetimit

është ajo e hakmarrjes, ndërsa po hetohet dhe në pista të tjera. Policia dhe prokuroria vijnë intensivisht hetimet, ndërsa po kalojnë në sitë dhe kamerat e sigurisë së bizneseve të zonës së përreth për zbardhjen e plotë të ngjarjes. Ndërsa, mësohet se në vendin ku ka ndodhur vrasja



Vendi ku u ekzekutua Jurgen Kurti

mungojnë kamerat e sigurisë. Viktima ka qenë dy herë i shoqëruar për akuzën e vrasjes, por me pas është shpallur i pafajshëm. Konkretisht, ai ishte shoqëruar në

komisariat për vrasjen e babait të tij, ngjarje kjo e ndodhur në prill të vitit 2012 dhe më pas për ngjarjen ku mbeti i vrasur tregtari durrsak, Agim Arapi.

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me Përmbanues Gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. "Ibrahim Ruova", Pallati 64, Hyrja 8, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 03.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi I për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme. Ndërtësimi me sipërfaqe totale 186 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Shkodër me Nr.pasurie 2/613+1-6, Volumi 37, Faqe 232, Zona Kadasrale Nr. 8591 në pronësi të Z.Alfred Lec Mazi me vlerë fillestare në ankand 100.000 (njëqind mijë) EURO.
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com;

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me Përmbanues Gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. "Ibrahim Ruova", Pallati 64, Hyrja 8, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 02.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi I për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme. Apartment me sipërfaqe 50 m² regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 5/194/1+1-0, Volumi 7, Faqe 177, Zona K.adasrale 220 në pronësi të debitorit Z.Arjan Xhevat Gjonaj me vlerë fillestare në ankand 100.000 (njëqind mijë) EURO.
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com.

Koncesionari i landfillit "Integrated Energy B.V" merr tarifa nga bashkia dhe nga ndërtuesit për dherat

Skandali i Sharrës, Klosi i shmangjet

Ministri i Mjedisit pranon dy tarifatat që paguan bashkia

Ministri i Mjedisit Blendi Klosi i shmangjet skandalit që po ndodh në landfillin e Sharrës ku bashkia i paguan dy tarifa koncesionarit. Ai pranoi se ky fenomen ndodh, por pa shpjeguar arsyeën e kundërvajtjes që, sipas tij, është normale. I ftuar në rubrikën 'Opinion' në News24 për çështjet e krizës politike ministri i Mjedisit dhe Turizmit Blendi Klosi komentoi edhe aferën abuzive të koncesionarit në landfillin e Sharrës. Përmes kronikave në edicionet informative, News 24 ka denoncuar skandalin, në të cilin me miratimin e Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Mjedisit ndërtuesit detyrohen që atë që shkarkojnë në landfillin e Sharrës duhet të paguajnë për llogaritë të kompanisë "Integrated Energy B.V" tarifën prej 480 lek për tonë për dherat.



Ministri i Mjedisit Blendi Klosi

"Demokracia ka këtë të mirë se mund të pasqyrohet në vërtetat. Duhet të bëjnë një investigim si janë hyrjet në qytetet e tjera. Mbetjet që dalin nga ndërtimet hidhen vend e pavend. Përmes një kontrate është dhënë landfilli i Sharrës që të hidhen inertet. Këto janë mallra që ndotin ambientin. Kjo që ndodh në Tiranë

duhet të ndodhë kudo. Është një kosto që duhet të paguhet dhe nuk është kosto shtesë. Deri më sot dherat hidheshin në shtratet e lumenjve. Landfilli i Sharrës është vendi për dherat dhe mbetjet inerte. Landfilli është për të gjitha dherat e dala nga ndërtimi. Të gjithë ndërtuesit kanë në lejen e tyre të ndërtimit të

përcaktuar vendin për inertet. Vend depozitimi i mbetjeve është pjesë e lejes që merr firma. Kjo që ndodh në Tiranë duhet të ndodhë kudo në qytetet shqiptare. Kush do të marrë dherat le të shkojnë ta marrin në landfill me leje nga bashkia. Duhet të ketë vend depozitimesh ligjore për të gjitha llojet e mbetjeve. Unë

nuk bëj vlerësimin se si janë këto mbetje. Ai vend është përcaktuar nga bashkia e Tiranës. Bashkia paguan vetëm një tarifë, e cila është për mbetjet urbane. Paguhet për grumbullimin e dheut dhe ka kosto" - u shpreh Klosi, ndërsa nuk e konkretizoi një përgjigje se përse Bashkia e Tiranës duhet t'i paguajë dy tarifa koncesionarit në landfillin e Sharrës. Fillimisht Ministri i Mjedisit u shpreh se Bashkia e Tiranës i paguan një tarifë kompanisë koncesionare, por më pas u detyra të pranojë edhe tarifën e dytë, dhe për të, ky nuk përbën asnjë problem. Por ministri nuk nguroi t'i dalë në mbrojtje koncesionarit pa bërë dallimin mes inerteve dhe dherave të pakontaminuara sikurse e përcakton edhe direktiva e Bashkimit Europian. Klosi shkon më tej kur thotë se një praktikë të tillë do ta kërkojë ta aplikojnë edhe bashkitë e tjera. "Ajo që di unë si ministër është që kjo që ndodh në Tiranë ndodh në të gjithë Shqipërinë. Ajo që ndodh në Tiranë do kërkojë me forcë të ndodhi në të gjithë Shqipërinë. Mendoni se në një vend tjetër jashtë Shqipërisë, të gjithë ndërtuesit, mund të marrin dhe të hedhin dheun jashtë rrugës? Duhet të marrin atje dhe është pa pagesë. Ku do hidhen këto inerte? Deri më sot hidheshin nëpër shtratet e lumenjve. Dilemi hipini makinës sa dilni tek ura e Gjolës kur shkon për në Krujë e shikon në dy krahët e rrugës nacionale vend e pa vend"-u shpreh Klosi.



Marrëveshja e Sharrës, ja shkeljet "me dy këmbë"

Në marrëveshjen koncesionare për landfillin e Sharrës vërehet se në asnjë prej pikave të renditura mbi detyrimet që duhet t'i paguhen kompanisë, nuk rezultoi tarifa prej 480 lekë/ton që kamionët e ndërtuesve me dhera janë të detyruar të paguajnë në landfill. Në dokumentin figurojnë vetëm dy tarifa që i paguhen koncesionarit. Bëhet fjalë për tarifën prej 29 euro për çdo ton mbetje urbane që depozitohet në Sharrë nga Bashkia e Tiranës dhe e dyta pagesa që koncesionari përfiton nga shitja e energjisë elektrike të prodhuar nga impianti i përpunimit të mbetjeve. Kjo vërteton faktin flagrant se landfilli i Sharrës iu 'gllabëron' në mënyrë abuzive dhe të jashtëligjshme firmave ndërtuese një tarifë të panëshkruar në kontratë. Njësoj si biznesin privat edhe Bashkinë e kanë detyruar të paguajnë tarifën prej 480 lekësh për çdo ton dherash që dërgon me mjetet e saj në landfill. Ky vendim absurd shton të ardhurat e kompanisë "Integrated Energy B.V", e cila fut thellë duart në xhepat e taksapaguesve kryeqytetas.

ABUZIMET

Landfilli i Sharrës iu 'gllabëron' në mënyrë abuzive dhe të jashtëligjshme firmave ndërtuese një tarifë të panëshkruar në kontratë. Njësoj si biznesin privat edhe bashkinë e kanë detyruar të paguajnë tarifën prej 480 lekësh për çdo ton dherash që dërgon me mjetet e saj në landfill.

Prodhimi i qumështit, lidhet marrëveshja për cilësi super

Marrëveshje për përmirësimin e prodhimit të qumështit në Shqipëri përmes modelit Dairy Hub. Përmes modelit Dairy Hub, Tetra Laval Food for Development mbështet klientët e Tetra Pak duke i lidhur ata me fermerët e vegjël dhe duke u ofruar asistencë teknike, njohuri praktike dhe trajnim për zhvillimin e prodhimit dhe grumbullimit të qumështit. Qëllimi i Dairy Hub është rritja e vëllimit të prodhimit të qumështit duke integruar mbajtësit e vegjël në zinxhirët e furnizimit të bulmetit. Në Shqipëri, partneriteti synon të përfshijë më shumë se 3,000 fermerë, prodhimi dhe të ardhurat nga qumështi të të cilëve pritet të rriten me të paktën 20-30%. Guillaume Latourette, Drejtor Menaxhues pranë Tetra Pak për Europën Juglindore tha: "Ne jemi shumë të kënaqur për krijimin e qendrës së parë të bulmetit Dairy Hub në Europë, e cila synon të përmirësojë produktivitetin e bulmetit,



të rrisë të ardhurat e fermerëve dhe të sigurojë një furnizim afatgjatë të qumështit cilësor të prodhuar në vend, pa rritur kostot e grumbullimit. Jemi të bindur se me përpjekje të përbashkëta mund të krijojmë përfitime për të gjitha palët: fermerët, përpunuesit e qumështit, ekonominë vendase si dhe konsumatorët", tha ai. "Është gjithmonë kënaqësi e veçantë për mua si ambasador i Suedisë, të shoh kompanitë suedeze që forcojnë prezencën e tyre në tregun shqiptar! Më vjen mirë që Tetra Pak dhe klientët e saj të bulmetit an-

gazhohen në zhvillimin e prodhimit të qumështit nga fermerat e vogla në Shqipëri, një sektor që ka shumë nevojë si për investime ashtu edhe për asistencë teknike. Ne kemi parë që modeli Dairy Hub me mbështetjen e Suedisë ka funksionuar mirë në shtete të tjera si Bangladeshi dhe Kenia. Është nder për ambasadorin suedeze në Shqipëri që nënshkrimi i partneriteteve të para Dairy Hub të Tetra Pak në Europë realizohet në ambientet e ambasadës sonë," tha në fjalën e tij ambasadori i Suedisë, Z. Johan Ndisi.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR I SHOQUAR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shtypja e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar i shoqëruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 54,345,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutjesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STNALLTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shtypje e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 19 Prill 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



Mark Peterson, konsulent i mbi 500 sipërmarrjeve amerikane

Profesori amerikan te "Luarasi": "Marketoni" në sytë e Europës

TIRANE

Studentët e ekonomikut të universitetit "Luarasi" kanë mirëpritur lektorin e radhës në kuadër të bashkëpunimeve që ky universitet ka me partnerët ndërkombëtarë. Mark Peterson është profesor i marketingut dhe praktikave të qëndrueshme në biznes, në Universitetin Wyoming në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, konsulent i mbi 500 sipërmarrjeve amerikane dhe botues i dhjetëra librave dhe studimeve shkencore mbi marketingun. Në leksionin e mbajtur para studenteve, ai prezantoi studimin e tij në lidhje me qëndrueshmërinë dhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, porë në këndvështrimin e zhvillimit rajonal ku krahasoi treguesit ekonomik. Në optikën e tij, Shqipëria duhet të ruajë me fanatizëm burimet për gjeneratat e ardhshme. Evropianët sipas Peterson janë klientë potenciale që duan të afrohen me vendin tonë nëse plotësojnë tre komponentë. Disa këshilla i drejton edhe qeverisë shqiptare:

"Shqipëria të ruajë me fanatizëm burimet për gjeneratat e ardhshme"



Mark Peterson, profesor i marketingut dhe praktikave të qëndrueshme në biznes, me studentët e Fakultetit të Ekonomikut, të universitetit "Luarasi"

"Së pari, ju duhet të kuptoni klientët, duhet të kuptoni evropianët. Ata janë në kërkim të bizneseve që op-

erojnë sipas mënyrës së tyre. Kjo do të thotë se ata fokusohen tek mbrojtja e mjedisit, kujdesi ndaj ko-

munitetit dhe të jenit një qytetar i mirë në vendin përkatës. Europianët kërkojnë sisteme të qën-

PETERSON
Mark Peterson është profesor i marketingut dhe praktikave të qëndrueshme në biznes, në Universitetin Wyoming në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, konsulent i mbi 500 sipërmarrjeve amerikane dhe botues i dhjetëra librave dhe studimeve shkencore mbi marketingun.

shpërndanin më shumë para tek bizneset. Qeveria juaj duhet të ketë më tepër besueshmëri në sytë e Europës, kjo ndodh kur ka më pak korrupsion dhe dhënie rryshfeti. Këshilla ime është: paguani zyrtarët tuaj me paga më të mira, zgjidhni gjyqtarët më të mirë, mundësoni media të lirë. Gjithë këto do të ishin sinjale për evropianët që ju e keni seriozisht dhe dëshironi shumë të jeni brenda komunitetit evropian, mendoj se kjo do të mirëprejete në Europë".

Përgjegjësjë e Departamentit të Administrimit Biznesit në Fakultetin Ekonomik të "Luarasit", dr. Aelita Mani shprehet se leksioni i profesorit amerikan u shërben studenteve për të reflektuar për sfidat e së nesërme.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

FTESE PER KUOTIM KOMBETAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbim konsulence në fushën e redaktimit (*proofreading*) në gjuhën angleze për përcjelljen në publik të informacionit të BSH për vitin 2019".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Ftesë për kuotim kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 472,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim.

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 27 Mars 2019, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,840,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 12 Prill 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.


ALUIZNI në 5 vitet e fundit ka kompensuar 16.273 përfitues, që morën 40 milionë USD

Artan Lame: Lista me 2300 pronarët, fondi 50 milionë lekë Miratohet fondi, përfituesit në 19 qytete

ALUIZNI publikon listën me 2300 pronarë që u është zënë toka nga ndërtime pa leje dhe kanë gati kompensimin. Bëhet fjalë për 700 pasuri, ose rreth 2300 pronarë, pasi në secilën pasuri përfshihen emrat e disa trashëgimtarëve, të cilët përfitojnë një fond rreth 50 milionë lekë dhe ju kompensohen një sipërfaqe e përgjithshme prej rreth 11 866,63 m². Përfituesit janë në Berat, Elbasan, Peqin, Librazhd, Gramsh, Durrës, Tiranë, Fier, Lushnjë, Shkodër, Korçë, Pogradec, Lezhë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Përmet, Kavajë dhe Kukës. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë të përfituesve së bashku me sipërfaqet takuese.

KOMPENSIMI

ALUIZNI bën të ditur se Këshilli i Ministrave miratoi në dt. 13.03.2019 vendimin me numrin më të madh të pronarëve, të cilët kompensohen për tokën e zënë nga ndërtime informale. Pronarët, të cilët prej vitësh kishin "humbur" të drejtën mbi pronën e tyre,



Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame

mpensimin e pronarëve të ligjshëm, me një total financiar rreth 4,5 miliardë lekë (rreth 40 milionë USD), ndërsa nga viti 2008-2013 kanë qenë të miratuar vetëm 15 VKM. Nga shifrat zyrtare të ALUIZNI-t rezultojnë se në 35 vendime të miratuara nga Këshilli i Ministrave kanë përfituar 16.273 trashëgimtarë. Deri më sot janë trajtuar 2694 pasuri, toka e të cilëve është zënë nga ndërtime pa leje. Ndërkaq, nga ALUIZNI janë në proces përgatitjeje edhe dy VKM të tjera me emra ish-pronarësh, të cilët do të kompensohen në vijim", - thuhet në njohimin e ALUIZNI-t.

EMRAT ME 2300 PËRFITUESIT E PRONARËVE QË U ËSHTË ZENË TOKA PA LEJE

Table with columns: Emër, Adesi, Mbledhësi, Nr. i pasurisë, Masa e kompensimit (m²), Cënimi (leke/m²), Shuma - Vlera e kompensimit (leke). Multiple sections for different municipalities.

Table with columns: Emër, Adesi, Mbledhësi, Nr. i pasurisë, Masa e kompensimit (m²), Cënimi (leke/m²), Shuma - Vlera e kompensimit (leke). Multiple sections for different municipalities.

Table with columns: Emër, Adesi, Mbledhësi, Nr. i pasurisë, Masa e kompensimit (m²), Cënimi (leke/m²), Shuma - Vlera e kompensimit (leke). Multiple sections for different municipalities.

Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)
FESTIM	BANUSH	IBRALIU	80/41	223.5	507	113314.5
BESNIK	HASAN	HYSËNBELLI	14/26	262.2	457	119825.4
FETAH	ASLLAN	FERATI	28/15	316.8	5140	1628352
BESNIK	ASLLAN	FERATI				
AFERDITA	YMER	TRESA				
BAJAME	YMER	TRESA				
FATOS	YMER	GJATA				
FLAMJUR	YMER	GJATA				
ISLAM	YMER	GJATA	33/22	356.4	2560	912384
LAJE	YMER	ALLA				
LLJANA	YMER	KODRA				
MIMOZA	YMER	KRASNICA				
NADIRE	YMER	HASA				
Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	655
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	078
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	498
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	753
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	978
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	776
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	119
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	866
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	380
Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	460
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	550
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	549
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	426
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	947
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	906
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	498
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	978
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	417
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	125
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	116
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	315
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	952
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	321
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	119
Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	105
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	953
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	866
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	865
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	900
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	622
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	752
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	380
	QARKU	TIRANE	ZONA KAD		ASTRALE	550
BEDRI	ISUF	BALI				
LUMTURI	ISUF	BITRI				
VJOLLCA	ISUF	BIBAJ	211/146	227.1		2560
RAZJE	ISUF	MYRAZI				
FATBARDHA	ISUF	MATUKA				

ALTIN		SHABA				
SHABAN		SHABA				
LAVDIM	GEZM	SHABA				
XHEVDET		SHABA				
DALLENDYSHI		SHABA				
DRITA		SHABA				
ENVER		RADA				
LULZIM		HOXHA				
ALFRED		SHABA				
EDMOND		SHABA				
BAKUSHE	REXHEP	SHABA				
MUHAREM	REXHEP	SHABA				
ISMETE		RADA				
FRANVERA		RADA				
JUSUF		RADA				
Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)
SULLTANE		SHABA				
BUKURIE		SHABA				
NEKHILJE		SHABA				
MARJANA		SHABA				
LEJLA		SHABA				
MERITA		BEGA				
ARBEN		SHABA				
SLVANA		KASEMI				
CAJE		KURDARI				
IBRAHIM	RAMAZAN	KURDARI				
MYSLYM	RAMAZAN	KURDARI	26/15	181.6	4242	770347.2
HAVA	RAMAZAN	KURDARI				
HAXHIRE	RAMAZAN	MALAJ				
HYSNI	DERVISH	BARZIU	1175/12	43.8	4242	185799.6
ILIRJAN	SETALI	MANE	1175/10	456.2	4242	1935200.4
SHERIF		TOQI	225/89/36	125.4	4242	531946.8
BASHKIM		TAFANI	225/89/37	106.8	4242	453045.6
FADIL	VELI	KUMEZINI	225/47/1	12.1	4242	51328.2
XHEMAL	HALL	HOXHA	367/54	388.8	230	89424
HAMIT	AVDI	GJELDKU	111/45	264	479	126456
NAIM	QAZM	LULI	55/40	307.2	479	147148.8
FADIL	ALI	DERVISHI	243/9	381.9	289	110369.1
MYSLYM		MALI	302/2	363.6	2560	930816
GANI		BLALI	200/7	154.4	878	135563.2
XHEMAL		BLALI	200/3	84.1	878	73839.8
HAZIZ	QAZM	TERZIU	124/2	291.9	878	256288.2
Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)
Besnik		Hysi	13/67	331	10777	3567187
Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)
Androniqi	Jorgji	Dalla				
Stavriulla	Jorgji	Dalla				
Jorgji	Jorgji	Dalla				
Aleksandra	Jorgji	Dalla				
Janilla		Kapamiri	579/4	7.4	150	11100
Gsnifo		Vasilu				
Marina		Oosa				
Camato		Muka				
Fotino		Papa				
Foto		Hasimi	617/25	7.3	150	1095
Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)
AHMET	HASAN	HAXHIA	73/69	432.6	472	204187.2
Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)
MAKSYM		GEGA				
PERPARIM		GEGA				
FATO		MASKAJ				
MIRJETA	ALM	XHELKJ	44/207	500	10903	5451500
FJONA	FATOS	DOLLANI				
SLVANA	ALM	ALIKE				
ZAMIRA		VELO				
Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
10	11	12	13	14	15	16 (16=14*15)
EDLIRA		KUTA (SUONI)		142.03		77,974.47
IBAJETE		KORRIKU (SUONI)		15.78		8,663.22
MYZEJEN		BAXHAKU (SUONI)		15.78	549.0	8,663.22
RUZHDI		SUONI	149/35	142.03		77,974.47

VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 20 Mars 2019

GAZETA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela Aliaj

"BULEVARDI POLITIK"

- Lufta për pushtet bën "armiç" Nard Ndokën dhe Petro Koçin
- Ish-deputetët e LSI, në protestë për të rrëzuar qeverinë dhe të qeshur
- Katër leshverdat socialiste të Komisionit të Medias bëhen bashkë
- Dasma Mesut Ozil fut në sherr Merkelin dhe Erdoganin

I habiti të gjithë, djali i Canës di katër gjuhë dhe është vetëm 3 vjeç



Mediat serbe shkruajnë me urrejtje për Luanën, ajo u jep reagimin që të gjithë e prisim



Rrëfëhet stilistja: Frymëzimi dhe imazhi i bukurisë për mua është nëna ime



Rina Kuqo:

Stili im s'ka rregulla të përcaktuara, e gjej veten kudo

"Asnjëherë mos u sforconi të dukeni si dikush apo diçka që nuk e ndjeni se jeni"

Grëfhet stilistja: Frymëzimi dhe imazhi i bukurisë për mua është nëna ime

Rina Kuqo:

Stili im s'ka rregulla të përcaktuara, e gjej veten kudo

"Asnjëherë mos u sforconi të dukeni si dikush apo diçka që nuk e ndjeni se jeni"

Pamela Aliaj

Në ditët e sotme të veshurit bukur dhe të qenit apo shndërruarit në një influencer (ndikues) është bërë një ndër pasionet më të mëdha që vazhatojnë vetëm zgjedhin të ndjekin. Moda dhe pasioni për të është i përhapur shumë nëpër botë dhe gjithkush në mënyrën e vet shfaq personalitetin në mënyrën e të veshurit dhe pse jo të jetë edhe një ndikues apo frymëzues për shumë të tjerë. E tillë është edhe Rina. Në një intervistë për Vip Pages të 'Gazeta Shqiptare', studentja për fashion designer na rrëfen pasionin e saj për botën e modës. Si lindi dëshira për të ndjekur këtë rrugë dhe frymëzuesit e saj që e nxitën atë të nxjerrë në pah më të bukurën e saj. "Pasioni për modën është i trashëguar," thotë ndër të tjera Rina. Ndërkaq lidhur me tendencat e kësaj pranvere 2019, blogerja na jep sugjerimet e saj për ngjyrat dhe stilin e veshjes që është më 'in'. Për më tepër ndiqni intervistën e mëposhtme:

Jeni një studente e për fashion design (stiliste). Si lindi pasioni për modën?

Pasioni për modën lindi që në moshë shumë të herët. Duke qenë se kam patur muzë frymëzimi dhe imazh bukurie nënën time, e cila është kujdesur gjithmonë për pamjen e saj, rrjedhimisht kjo ka ndikuar dhe tek unë, pra është e trashëguar.

Shfaqeni në foto me veshje të ndryshme plot ngjyra. Çfarë lloj stili i përshtatet më tepër Rinës?

Mund të them që unë e gjej veten tek çdo stil. Mendohem t'i ndërthur stilet me njëra-tjetrën. Stili im nuk ka rregulla të përcaktuara. Me personalitetin që unë kam dhe me gjendjen personale e bëj çdo stil të duket i imi.

Këtë pranverë cili është kombinimi më perfekt sipas jush?

Këtë pranverë unë sugjeroj të luajmë me ngjyrat e ëmbla dhe të ngrohta. Veshje me grep, tantella, materiale mëndafshi, saten, shkëlqime, temina, ngjyra fosfor, printe të ndryshme, transparencë, denim i pazakontë, stili barbi etj.

Cila ka qenë eksperiencia që ju ka lënë më tepër mbresa në fushën e modës?



Ekspierencia më e bukur të cilën po e shijoj pa masë është shkolla e fashion design që jam duke ndjekur, e cila po më shërben realisht të hyj thellë në rrenjë të fillësës së modës dhe të njoh kapacitetin tim dhe ta përmirësoj e ta avancoj atë drejt njohurive të cilat nuk i merr dot në jetën e zakonshme. Gjithmonë i kujtoj vetes



shprehjen: zgjidh një punë që e dashuron dhe nuk do të duhet kurrrë të punosh një ditë në jetën tënde.

Pas çdo stilisti të ri qëndron dikush që e frymëzon goftë dhe indirekt në punën e tij. Kush është për ju ai/ ajo që ju frymëzon më tepër?

Kohët e fundit po e ndjek jetën,



2019 dhe ç'lloj kombinimi sugjeroni që të shfaqet sa më bukur?

Ngjyrat më 'in' të 2019 janë disa: 1- roza 2- jeshilja e errët 3- e verdha 4- korali 5- ngjyra blu 6- kafia. Ngjyra kafe përpos stinës së dimrit do jetë shumë e pranishme edhe në verë apo pranverë. Tonalitetet e tokës janë të preferuara në çdo stinë të vitit.

Përveç modës, cilat janë pasionet e tjera të Rinës?

Jo të gjitha aktivitetet unë i njoh me ndjekësit e mi. Madje mendoj se këtë fakt nuk e di askush (qesh). Po e zbuloj këtu pra: unë bëj shumë ecje. Jam njeri shumë aktiv dhe energjik. Mendohem të ha shumë shëndetshëm dhe të kem një regjim maksimal për të nisur një ditë sa më mbarë. Ecja më ndihmon të mendoj x objektivat që kam në jetë përpos faktit se të mban trupin në formën që dëshiron.

Dihet se përkushtimi ndaj modës kërkon kohën e saj dhe ka shumë angazhime. Si është një ditë e zakonshme e juaja?


Një ditë e zakonshme e imja është shumë intensive. Në mëngjes shkoj në shkollën që po ndjek për modën, dreqës ja le kohën për bashkëpunime apo projekteve të ndryshme që mund të kem, pasdite jam në masterin e shkollës së parë, dhe darkës një ecje relaksuse. Kështu përmbillet e gjithë dita ime.

A keni patur propozime lidhur me përfaqësimin e ndonjë brandi të preferuar apo keni ndonjë në proces?

Kam patur dhe kam shumë propozime. Aktualisht jam duke bashkëpunuar me një brand veshjesh dhe çantash, në pamundësi kohe për t'u marrë me të gjitha ofertat që më vijnë.

Çfarë do të donit të ndryshonit në stilin e të veshurit të të rinjve shqiptarë që nuk ju pëlqen dhe që e shihni shpesh?

Në stilin e të rinjve shqiptar, unë mendoj se veshja jonë tregon pjesërisht personalitetin tonë. Pra dukshmëria dhe impakti i parë kanë shumë rëndësi në mënyrën se si ne e prezantojmë veten. Unë thjesht sugjeroj që njerëzit të vishen ashtu si ata ndihen. Unë personalisht ndihem dhe jam shumë pozitive energjike dhe këtë jam munduar ta shpreh nëpërmjet ngjyrave. Asnjëherë mos u sforconi të dukeni si dikush apo diçka që nuk e ndjeni se jeni.



Pak ditë më parë një nga çiftet më të dashura të mediave, Blero Muharremaj dhe Afrona Dika dhanë lajmin e mirë se dashurinë e tyre shumë shpejtë do ta kurorëzojnë me martesë. Çifti planifikojnë që martesën ta bëjnë në shtator të këtij viti, ndërsa bëhet e ditur se përgatitjet për dasmën tashmë kanë filluar. Afrona në rrjetin social 'Instagram' e ka postuar një foto duke lënë për të kuptuar se përgatitjet për dasmën e madhe kanë filluar. "Është gjithçka rreth detajeve", ka shkruar ajo, duke treguar pak nga dekorat që do të jenë në tavolinat e të ftuarve. Dasma e Bleros dhe Afronës pritet që të jetë një nga dasmat më të përfolura të vitit. Mezi presim të shohim Afronën në fustanin e nusërisë që me siguri do të jetë përrallor ashtu si gjithë detajet e tjera.




Së shpejti lidhin kurorë, ja pamjet e para të dasmës magjike të Bleros dhe Afronës

Edhe pse është vetëm tre vjeç, ai Errin të njohë katër gjuhë të huaja. Në fakt, s'ka se si të ndodhë ndryshe duke qenë se ka një mama italiane, e një baba shqiptar. Mesa duket për djalin e Lorik Canës mësimi i gjuhëve të huaja është kthyer në dhunti. Bashkëshortja e ish-Kapitenit të Kombëtares është pyetur nga ndjekësit në 'Instagram' se në çfarë gjuhe komunikojnë me të birin Boiken. "Unë i flas Boikenit në italisht dhe frëngjisht. Loriku i flet vetëm shqip. Në shkollë i flasin shqip dhe anglisht. Boiken i kupton të gjitha dhe flet nga pak të gjitha gjuhët...Do t'i duhet pak kohë, por do të ketë fat", ju përgjigj Monica ndjekësit. Pra, Boiken vetëm 3 vjeç njeh katër gjuhë!



I habiti të gjithë, djali i Canës di katër gjuhë dhe është vetëm 3 vjeç

Ajo njihet për stilin e saj ekstrovert dhe të veçantë të të shprehurit e të jetesës. Kësaj radhe këngëtarja Filloreta Reçi (Fifi), vendosi të bënte një tatuazh gjigand në shpinë, duke dhënë një mesazh së pari, për veten e saj, por edhe për të gjitha gratë e forta. Këngëtarja ka mbuluar pjesën e shtyllës kurri-zore me një shprehje në gjuhën angleze: "Sometimes an angel, sometimes a hell raiser, always a strong woman", e cila në shqip përkthehet: "Disa herë një engjëll, disa herë një ferr-ngritës, gjithmonë një grua e fortë". Kjo pas gjithë bullizmit apo paragjytimeve që ka marrë ajo dhe çdo femër tjetër. Frymëzues apo jo?



Këngëtarja bëri tatuazhin gjigant, që frymëzon të gjitha femrat



Mediat serbe, në një titull të një gazete, shkruante se këngëtarja e moderatorja e famshme shqiptare Luana Vjollca, ka urrejtje ndaj Serbisë. Kjo gazetë, e cila ka përdorur fotografinë e Luanës me plis dhe me flokët e kuqe, pamje kjo të cilën ajo e kishte në një nga edicionet e emisionit të saj "Shiko kush Luan" për 28 Nëntor, shkruan se Luana përkrah krijimin e një Shqipërie të Madhe etnike, ku do përfshihej edhe Kosova. Ndërsa nuk ka munguar reagimi i Luanës, e cila e ka publikuar në 'Instagramin' e vet këtë artikull, duke e pohuar se çdo gjë që është thënë aty, është plotësisht e vërtetë. "Gazetat serbe paskan shkruar se sa shumë e urrejtje Serbinë dhe sa shumë e dua Shqipërinë e madhe, Kosovën. Dhe unë po ju them: Shumë mirë që e dini!", ka shkruar moderatorja mbi lajmin e gazetës serbe të postuar në 'Instagram'. Një reagim i pritur ky i moderatores, si do të reagonit ju?

Mediat serbe shkruajnë me urrejtje për Luanën, ajo u jep reagimin që të gjithë e prisnim

BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

POLITIK

Lufta për pushtet bën "armiç" Nard Ndokën dhe Petro Koçin

Opozita duhet të ndalojë hapat prapa dhe të fillojë të ecë përpara. Ky ishte statusi në 'Facebook', i zv.ministrit të Mbrojtjes, Petro Koçi, njëherësh dhe aleat i PS-së në qeverisjen e majtë. Por ky status si një qëndrim për krizën politike që po përjeton vendi ka rënë në sytë e kreut të PDK-së, Nard Ndoka, i cili ka komentuar statusin e zyrtarit të lartë të qeverisë. "Petro, mos shkruaj në rrjetet sociale në orarin e punës. Mos bëj politikë, se të kemi besuar sigurinë kombëtare", - shkroi Ndoka si replikë ndaj kundërshtarit të tij politik. Po përgjigja e Koçit ka qenë e menjëhershme, duke i replikuar me ironi se "e mbara e forcon sigurinë kombëtare". Këto replika nuk qëndruan për shumë në 'Facebook', mbase Koçi për të shmangur ndonjë koment të tepërt i ka fshirë nga 'Facebook'.



Ish-deputetët e LSI, në protestë për të rrëzuar qeverinë dhe të qeshur

Për disa javësh tashmë opozita po proteston duke kërkuar një qeveri tranzitore dhe zgjedhje të parakohshme. Për këtë ajo protestoi edhe të shtunën e shkuar, ku mbështetës të PD-së dhe LSI-së u tubuan të Kryeministria dhe Kuvendi i Shqipërisë. E ndonëse është një protestë serioze që ka në thelb të saj denoncimin e keq-qeverisjes dhe pushtetin e vjedhur, kjo nuk i ka penguar aspak përfaqësuesit e këtyre dy forcave që edhe përballë gazit lotsjellës dhe ujit të ftohtë të ruajnë sportivitetin dhe optimizmin. Kjo vërehet më së miri edhe në fytyrat e ish-deputetëve të Lëvizjes Socialiste për Integrim, Vangjel Tavo, Gledion Rehovica, të cilët para aparatit fotografik dinë të dalin gjithmonë të qeshur.



Dasma Mesut Ozil fut në sherr Merkelin dhe Erdoganin

Shefi i kabinetit të Kancelares gjermane, Merkel u shpreh i mërzitur pas lajmit se ish-futbollisti i Kombëtares, Mesut Ozil i kishte kërkuar presidentit turk, Recep Tayyip Erdogan të ishte dëshmitari i tij në martesë. "Patjetër që na trishton si lajm, pasi dikush që ka mbajtur kaq gjatë fanellën e ekipit të Gjermanisë, i cili u përball me një reagim të tillë të opinionit gjerman pas takimit të parë me Erdogan, dhe e gjitha kjo të përfundojë në këtë mënyrë, ky është një zhgënjim i vërtetë për tifozët dhe mua gjithashtu", u shpreh në një intervistë për të përditshmen "Bild", Helge Braun, shefi i kabinetit të Angela Merkel. "Në fund të fundit, bëhet fjalë për një vendim privat që duhet ta pranojmë", tha zyrtari. "Bild" publikoi të dielën lajmin se futbollisti mendonte t'i kërkonte kreut të shtetit turk të ishte dëshmitari i tij në kurorëzimin e martesës. Data dhe vendi i ceremonisë nuk bëhen të ditura.



Katër leshverdhat socialiste të Komisionit të Medias bëhen bashkë

Lindita Nikolla, Milva Ekonomi, Vilma Bello dhe Almira Xhembulla janë të katërta deputete të Partisë Socialiste në Kuvendin e Shqipërisë. Por veç përkatësisë dhe bindjeve politike ato kanë dhe disa të përbashkëta të tjera. Të katra ato janë anëtare të Komisionit parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Por jo vetëm kaq, ajo që i bashkon më shumë dhe që i bën që të bien në sy sa herë që janë bashkë është natyrisht ngjyra e flokëve. Ato janë të katra bionde dhe jo më kot edhe midis kolegeve njihen si biondet e Komisionit të Medias. Të katra deputetet bionde kanë pozuar edhe për të shkrepur një foto së bashku për fotografimin Agim Rama, të cilën ne po e publikojmë.

Këshilla

Sa herë ke pasur rast të dëgjosh fjalën e urtë: "Bukuria buron nga brenda!? Kjo vlen edhe për bukurinë flokëve, sepse ajo që e hamë (apo nuk e hamë) ndikon në pamjen e flokëve.

Flokët patjetër duhet të furnizohem me sasi të mjaftueshme të lëndëve ushqyese dhe ndërtuese që janë tepër të domosdoshme për rritjen dhe cilësinë e tyre. Burimet më të mëdha të elementeve të tilla të rëndësishme gjenden në vitaminat dhe mineralet. Prandaj, kujdes të plotë kushtojti ushqimit tënd! Ja disa këshilla të specialistëve për të pasur flokë të bukur dhe të shëndetshëm.

1. Sa më shumë që t'i lash flokët, ato do të jenë më të shëndetshme. Ajri i ndotur, yndyra dhe djersitja ndikojnë në flokët tuaja më shumë se ç'mendon. Flokët laji së paku dy herë në javë.

2. Në qoftë se flokët i lan pothuajse çdo ditë, përmbaju këshillës së ekspertëve të cilët thonë se shampion duhet ta vendosni në zverk, në tëmth dhe në ballë: tri pikat më të rëndësishme të cilat ndër të parat krijojnë yndyrë. Pastaj ngadalë formo shkumën me ujë të vakët në qoftë se ke flokë normale apo të yndyrshme, përkatësisht me ujë të ftohtë në qoftë se flokët i ke të thata. Shampion lëre të veprojë disa minuta dhe pastaj flokët krihi me krehër me dhëmbë sa më të gjërë. Vetëm pasi t'i kesh bërë këto veprime laji flokët.

3. Harroje shprehinë e vjetër të fërkimit të tepër të flokëve me peshqir pas larjes. Do të ndjehesh më komode, por edhe për flokët do të jetë më mirë në qoftë se i mbështjell vetëm me një peshqir të thatë. Peshqiri i mbledh pjesën më të madhe të lagështisë nga flokët. Pas një kohe merr edhe një peshqir të thatë dhe fërkoji me të butë flokët.

4. Intervali kohor për tharjen e flokëve me tharëse është midis 25 dhe 30 minutash. Në këtë mënyrë majat e flokëve nuk do të pësojnë.

5. Flokët me minival thaji me tharëse vetëm pjesërisht. Pjesën tjetër të tharjes lërja ajrit. Vetëm pas tharjes mund t'i krehësh dhe të bësh krehjen.

6. Kundër pëlçitjes së majave të flokëve ilaci më i thjeshtë është regeneratori shtëpiak nga të kuqtë e vezës dhe vaji i ricinës. Që të bësh regeneratorin të nevojitet vetëm një vezë dhe vaji i ricinës. Vajin ngrohe pak dhe përziejë pikë për pikë me vezën, deri sa të krijohet si majonezë e vërtetë. Flokët



Si të kemi flokë të bukur dhe shëndetshëm?



mos i laj, por me regenerator fërkoji majat e flokëve dhe mbështilli në një foli alumini, në kokë vër një kapelë plastike dhe mbaji sa më gjatë të jetë e mundshme. Pastaj flokët laji mirë!

7. Në qoftë se flokët i ke të ndara në mes, kij kujdes që kohë pas kohe vijën ta lëvizësh për një centimetër majtas apo djathtas, në mënyrë që të mos bëhet një vijë e theksueshme pa flokë.

8. Në qoftë se flokët të "shprishen", mos provo t'i rregullosh duke i krehur nga rreña, por nga majat, sepse në atë mënyrë më pak dëmtohen.

9. Në qoftë se shfrytëzon lakun për flokë, para se të

shkosh në gjumë përherë duhet ta eliminosh nga flokët, duke i krehur mirë.

10. Në qoftë se dëshiron që krehja të jetë e shkëlqyeshme dhe natyrore, mos hidh llak drejtpërdrejt në flokë, por në krehër apo në duar dhe me to spërkat flokët.

11. Në qoftë se nuk mundesh apo nuk arrin që t'i lash flokët, ndërkaq nuk dëshiron që të duken të yndyrshme, qitu flokëve baby pudër dhe pastaj krihi mirë. Gjithsesi kjo këshillë vlen vetëm për ato që kanë flokë të shkëlqyeshme.

12. Në qoftë se dëshiron që flokët tuaja ngjyrë gështenje të duken më të shkëlqyeshme dhe më të bujshme, laji

në ujë në të cilin më parë ke zier lëvore arre (jo lëvozhga). Lëvoret ziej gjysmë ore dhe pastaj kulloji. Nga sasia e lëvoreve të cilat i ke përdorur varet nuanca e ngjyrës së flokëve.

13. Në qoftë se dëshiron ta ndërrosh ngjyrën e flokëve vetë në shtëpi, përherë me përpikëri përmbaju udhëzimeve. Sasinë e pashfrytëzuar të ngjyrës hidhe, sepse atë nuk do të mund ta shfrytëzosh herën tjetër.

14. Në qoftë se tashmë ke përdorur këna, flokëve mundesh vetëm t'u japësh një ngjyrë më të errët, por jo edhe t'i shkëlqesh. Derisa të mos rriten flokët, mos mendo për zbardhjen e zylyfeve.

15. Kurrë mos e tepro me prodhimet të cilat i qet në flokë - qoftë fjala për shampot, regeneratorët, shkumën apo xhelin. Një herë qit një sasi më të vogël, dhe në qoftë se të duket se ke qitur pak, mund ta shtosh pjesën tjetër.

16. Bojën e flokëve mos e vër në dhomë tepër të ngrohtë. Preparati mund të shkrihet dhe të rrjedhë në lëkurë.

17. Në qoftë se ke flokë bionde që anojnë nga ngjyra e zezë, shmangiu shampove të cilët mund t'i shkëlqejnë flokët. Ata, flokëve ngjyrë të errët, u japin ngjyrë të kuqërremtë.

18. Ushtrimi i rregullt, fitnesi, vozitja e biçikletës apo shëtitja ndikojnë mirë në

rritjen dhe shëndetin e flokëve.

19. Në qoftë se krehjen e formëson me furçë, shfrytëzoje atë që i përshatet më mirë flokëve tuaja: për karfica të buta janë të përshatshme furçat e holla, të rrumbullakëta, ndërkaq për flokë të gjatë furçat më të mira janë ato të gjera.

20. Provo që sa më pak t'i ngarkosh flokët me karfica dhe me llastikë, sepse kur janë të lira, më lehtë marrin frymë dhe janë më të shëndosha.

MIQTË E FLOKËVE
■ Krehrit me dhëmbë të mëdhenj

■ Brushat e buta për flokë

■ Balsamet dhe regeneratorët

■ Mbrojtësit nga nxehtësia

ARMIQTË E FLOKËVE

■ Ekspozimi ndaj rezeve të diellit

■ Ajri i ndotur

■ Ngjyrosja

■ Tharësja e papërshatshme

■ Llastikët elastikë për flokë

■ Dietat e papërshatshme, posaçërisht ato në të cilat shmangët ushqimi i pasur me vitaminën B, që është më se e domosdoshme për flokë.

MENYJA PËR FLOKËT TË SHËNDOSHË

Vitaminat dhe mineralet që ndikojnë në shëndetin dhe

bukurinë e flokëve

■ Vitamina B5: vezët, mishi, mish peshku, drithërat, tharmi

■ Vitamina H: të kuqtë e vezës, kërpudhat

■ Vitamina A: mëlçia, gjalpi, vezët, karota, spinaqi, kajsia

■ Vitamina C: majdanozi, lule lakra, patatja, molla, spinaqi, domatja, limoni, portokalli

■ Sulfuri: peshqit e detit dhe guacat, bizelja, spinaqi

■ Zinku: guacat, peshqit, mish

■ Bakri: bananet, dardhët, kumbullat, tharma e birrës, kakaaja

■ Hekuri: pemët e thara, spinaqi, vezët.

A E DINI SE?

- Flokët tona përmbajnë mesatarisht 120 mijë qime, ndërkaq është e natyrisht që në ditë të bien deri në 100 të tilla.

- Brenda një guaji flokët rriten mesatarisht gjysmë centimetri. Më shpejt rriten verës sesa dimrit.

- Flokët ngjyrë të errët përherë duken më të shkëlqyeshme, nga ato ngjyrë të çelët, sepse ngjyra e errët është më e dendur dhe thith më shumë dritë.

- Krehja nga distanca prej një kilometri mund të zbulojë femrën që pi shumë duhan, jo vetëm nga aroma e flokëve, por edhe nga pamja e tyre. Pirja e duhanit i than flokët dhe i bën më pak të shkëlqyeshme.

DIKTATURA

Filozofi që studioi në Paris, la ministrinë për shkak të përplasjeve ideologjike

GJERGJ KOKOSHI

Ministri që kundërshtoi partinë e vdiq në burg

Fatmira Nikolli

Më 1943, kur Tirana ka ndër ruar dy pushtues në 5 vite, Gjergj Kokoshi i bashkohet Frontit Nacionalçlirimtar. Është 39 vjeç, Nga Shkodra ku ka lindur më 1904, ka ikur për të studiuar në Itali dhe Francë për filozofi, është doktoruar në Paris për letërsi dhe në vitet 1930, është kthyer për t'u bërë profesor në gjimnazin shtetëror në Shkodër dhe në Tiranë. Rrethanat dhe dorëzimi i dalëngadalë i Shqipërisë nga ndikimi italian në pushtimin fashist, por edhe kundërshtimi i politikave të mbretit, e kanë bërë antifashist. Por edhe antifashist. Aq sa më 1940, kur ftohet të jetë pjesë në Konferencën e Parë të Studimeve Shqiptare, që shënoi themelimin e Institutit Mbretëruar të Studimeve, refuzoi të për arsye shëndetësore.

Kur lufta kishte filluar, Kokoshi kishte dëshmuar afilim me partizanët dhe lëvizjen e drejtuar nga Partia Komuniste. Pasi kishte propaganduar idetë antifashiste dhe përhapjen e tyre tek të rinjtë në shkolla, profesori kishte lënë klasat dhe ishte bërë pjesë e rezistencës së armatosur kundër pushtesit në veri të Shqipërisë, në Dibër, duke arritur të gradohej, deri kolonel.

Emri i tij fillon të bëhet i njohur pas Kongresit të Përmëtit, kur nis instalimi i regjimit komunist në Shqipëri. Filozofi i diplomuar edhe për letërsi, ishte zgjedhur anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar, strukturë e qeverisjes në atë kohë.

Historiana Enriketa Pandelejmoni, mbi studimin e së cilës bazohet ky artikull, thotë se duhet të jetë propozuar si i ngarkuar me punë për arsimin që gjatë ditëve të Kongresit në maj, pasi emri i tij gjendet në një dokument pa firmë, ndërsa zyrtarisht, Kokoshi u ngarkua më 20 qershor 1944. Enver Hoxha e prezantoi me elozhe të mëdha, si pjesëmarrës i Lëvizjes "njeri që nuk ka bërë kompromise dhe kompetent me eksperiencë në fushën e arsimit". Katër muaj më vonë, në mbledhjen e Këshillit në Berat, Kokoshi emërohet Ministër i Arsimit në qeverinë provizore të drejtuar nga Hoxha.

Megjithatë, siç mësohet nga Dosja Formulare e ish-deputetit Selajin Toto, edhe gjatë luftës, Kokoshi ishte i pakënaqur nga elementët e majtë ekstremë që ishin



TIRANË KOMBIAK 1946
1545 GJYQI I SAHË QËBIBASHIË, GJERGJ KOKOSHI
PËRFAJA TRUPIT GJYKUES

Portreti i profesorit që luftoi si partizan dhe ëndërroi një Shqipëri tjetër

në pushtet. Pavarësisht situatës, ish-profesori, organizon Kongresin e Arsimitarëve Antifashistë dhe përpilon platformën për arsimin. Është koha kur pikëpamja e Kokosit për zhvillimin cilësor të arsimit përplasat me pikëpamjen e Sejfulla Malëshovës për masivizimin e arsimit. Debate mes tyre ka edhe mbi kompetencat e Ministrisë së Kulturës Popullore, si dhe mbi zërin e ulët që i është lënë arsimit në buxhetin e vitit 1945, kur më parë i ishte rezervuar 13%. Kokoshi nis ta gjejë veten jashtë rryme, teksa ata që fituan luftën po konsolidonin pushtetin. Besonte, se Lëvizja Nacionalçlirimtare nuk që njëqind për qind e së majtës ekstreme. E dinte se në të kishte edhe të moderuar, por fakti që ata më ekstremistët morën pushtetin, nuk i pëlqente, madje, shkaktonte dëshpërim edhe të shumë të tjerë.

Pas rreth 80 ditësh ministër, përtej përplasjeve, profesori kuptoi që nuk arrinte dot të sillte në jetë vizionin e tij. Gjergj Kokoshi jep dorëheqjen më 13 janar 1945, ndërsa Malëshova është ministër i Kulturës e propagandë dhe më vonë ministër Arsimit.

Vijon të jetë pjesë e Këshillit Nacionalçlirimtar, i cili në gusht 1945 quhet Fronti Demokratik, por e shpreh hapur kundërshtimin e tij ndaj ligjit të ri zgjedhor, që nuk lejonte pjesëmarrjen në zgjedhje të partive të tjera.

Kjo ndodhte kur aleatët ndërkombëtarë, si SHBA e Brita-

I dorëhequr nga posti i ministrit, në mbledhjet e Këshillit ku ende ishte pjesë, Kokoshi ngulmonte të vinte në dukje dëmet e politikave të ashpra ekonomike, që sipas tij, mund të justifikoheshin për kriminelët e luftës

nia kishin vënë kusht për njohjen e qeverisë, mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Në zgjedhjet lokale Partia Komuniste vuri në lista njerëzit e vet, "të sprovuar në luftë, të vendosur dhe besnikë ndaj interesave të popullit". Tanimë po merrte në duart e veta drejtimin e shtetit, duke eliminuar më parë "përfaqësuesit e reaksionit". Gjergj Kokoshi kandidoi në zgjedhjet lokale të mbajtura në maj 1945, në Lagjen e Re në Tiranë, por nuk mundi të zgjidhej. Kishte marrë vetëm 17 vota.

Më 27-29 shtator, dy muaj para se të mbahehin zgjedhjet qendrore të 2 dhjetorit 1945, u miratua një paketë ligjore për to. Ligji

elektoral, Ligji mbi Asamblenë Kushtetuese si dhe Ligji mbi listat e votuesve, kufizonin zhvillimin e zgjedhjeve të lira. Fronti Demokratik që drejtohej nga komunistët nuk lejonte krijimin e grupeve të tjera politike, procesi i administrimit të votimit, nga komisionet të mbikëqyrësit sipas historianes Sonila Boçi ishte në duart e tyre.

Pakënaqësitë ishin të mëdha. Që kur ishin bërë diskutimet mbi hartimin e ligjit, Gjergj Kokoshi, në atë kohë Ministër i Arsimit, por dhe anëtar i Këshillit të FAËÇ ishte shprehur se nuk ishte i përshtatshëm me parimet demokratike. Ai doli hapur kundra miratimit të tij duke argumentuar se cenonte vendosjen e një rendi demokratik dhe pluralist. Vërejtje se në kushtet e pasluftës, ligji nuk u mundësonte njerëzve të arsimuar dhe të kualifikuar të kontribuonin dhe nuk u jepte kohën e mjaftueshme grupimeve jashtë Frontit për t'u organizuar dhe paraqitur kandidataturat e tyre. Ai theksonte se kjo binte ndesh me parimet e demokracisë liberale. I dorëhequr nga posti i ministrit, në mbledhjet e Këshillit ku ende ishte pjesë, Kokoshi, ngulmonte të vinte në dukje dëmet e politikave të ashpra ekonomike, që sipas tij, mund të justifikoheshin për kriminelët e luftës, por jo të merreshin masa të rrepta e rekuizim pasurie ndaj familjeve së tyre, sidomos kur personat në fjalë kishin vdekur. Ai këshillonte kujdes për tatin e jashtëzakonshëm mbi fitimet e luftës, sepse, siç po bëhej, ishte kthyer në makt për tregtarët.

I dorëhequr dhe në kushtet kur zëri i tij nuk dëgjohej, ndërsa masat e marra kishin shkakuar frikë kudo, Gjergj Kokoshi vendos të rimendojë pozicionin e tij brenda Frontit dhe mundësinë e largimit. Ai e dinte se në publik flitej kundra Frontit, e dinte se s'kishte liri dhe se vendi ishte në diktaturë, ndaj e shihte veten në zgjedhje jashtë listave të tyre. Prej kohësh, duke e njohur natyrën e tij, antikomunistë të tjerë e kishin kontaktuar që të organizohej me ta, ndonëse ndjehej pezmi mbi mënyrën si po bëhehin zgjedhjet dhe frika e kandidimit jashtë Frontit.

Ishte bashkë me të grupi socialdemokrat i Musine Kokalarit, por edhe simpatizanti i monarkistëve Qenan Dibra. E gjithë kjo, bëhej në kushtet e një terrori politik të nisur me gjyqet speciale e gjyqet e popullit të marsit 1945 në fillim



ndaj "kriminelëve të luftës", e më pas ndaj antikomunistëve në Veri.

Megjithëse situata nuk i favorizonte organizimet politike kundër qeverisë, presioni i ndërkombehtarëve, lejimi i gazetarëve të huaj në fushatë dhe në votime u bënë nxitës që jokomunistët të dilnin me listat e veta në zgjedhje. Me vetëm dy muaj kohë, në takimet e fshehta u kuptua që do ishte e vështirë të siguroheshin firmat e nevojshme për të shpallur kandidataturat apo grupin politik. U mbledhën vetëm 25-30 firma, krejt të pamjaftueshme. Më 17 Nëntor 1945 grupi doli me emrin "Bashkimi demokratik", si bashkim i rrymave politike me qëllim formimin e një opozite.

Në këtë kohë, Kokoshi kupton që është i nevojshëm hartimi i një programi dhe i një lutjeje, të nënshkruara prej disa "njerëzve të ndershëm me qëndrim politik korrekt". Programi ngjante me atë Frontit Demokratik, ndaj Kokoshi thotë se është kundra politikës së qeverisë shqiptare, që "don me bashkuje Shqipërinë me Jugosllavinë". Për të, ky bashkim ishte kundra vullnetit të popullit shqiptar, i cili "don që Shqipëria të mbetet shtet i përditshëm dhe sovran, na duhet ta rujmë një shtet të tillë, por pa Gjirokastër e pa Korçë nuk ka shtet shqiptar". Për çështjen e Kosovës, ndryshe nga të tjerët sugjeron të lihet mënjani për momentin "pasi Jugosllavia na ndihmon për me rujt integritetin tokësor". Studuesja Enriketa Pandelejmoni shpreh se Gjergj Kokoshi kishte besim tek misionet britanike dhe amerikane në Shqipëri dhe tek influenca e tyre mbi qeverinë shqiptare për t'i bërë presion për zgjedhjet e shtyrjen e tyre. Me nativitet dhe për habitin e pjesëmarrësve në mbledhje ai thotë se programi dhe lutja duhej t'i dërgohej qeverisë shqiptare, pasi ai kishte biseduar me Gjeneralin britanik Hodgson. Logjika e drejtë e Kokosit, mbi hapat që ndërmerren para zgjedhjeve për një grupim të ri politik, bëheshin në kohën e gabuar. Ai ende nuk e kish kuptuar.

Propozimi i tij pritet me skepticizëm nga pjesëmarrësit në mbledhje. E dinin që po të informonin qeverinë për formimin e kësaj partie, rrezikonin të arrestoheshin. Por Kokoshi këmbëngulte duke shtuar se duhej marrë parasysh edhe arrestimi në momentin që po krijonin një parti opozitare si Bashkimi Demokratik që përfshinte të pakënaqurit, monarkistët e socialdemokratët. Ishte rënë dakord që

Opinion i Ditës

Zgjidhja është zgjimi!

Nga Lutfi Dervishi

(vijon nga faqja 1)

... është rezultati i referendumi për Kushtetutën e vitit 1994.

Një pedagog i tij, tashmë në pension, e sqaron se Shqipëria ka votuar një kushtetutë tjetër, me ekspertët më të mirë ndërkombëtarë, në vitin 1998. Kushtetuta e votuar nga parlamenti dhe e konfirmuar nga populli në referendum është tjetërsuar aq shumë, sa nuk ka noter që e njehson me origjinalin.

Më 2008-n u ndryshua sistemi zgjedhor. Ndryshimi i sistemit nxori zbuluar fuqinë e kryetarëve të partive, tregoi se demokracia duhet të pushtojë partitë, ndryshe nuk e pushton dot vendin.

Më 2016-n, Kushtetuta ndryshoi pothuajse rrënjësisht për shkak të drejtësisë së re.

Studenti i juridikut mëson se "gjyqtarët e plepave", aq shumë të shpotitur, u përkasin teksteve të historisë. Drejtësia e re që po del nga vetingu pritet të jetë profesionale, e pa kapur nga qeveria, dhe do të vërë para përgjegjësisë çdo abuzues. Dita kur të gjithë do të jenë të barabartë para ligjit do të vijë. 30 vite kanë kaluar, por e rëndësishme është që ndërkombëtarët janë optimistë dhe populli i duruar.

Studenti i juridikut çuditet kur sheh se nuk ka më protesta në sheshin "Skënderbej" në Tiranë. Adeti i ri është të protestohet para zyrës së kryeministrit. Kryeqyteti është katërfishuar me banorë dhe po i afrohet njëmilionëshit, por për të mbushur bulevardin thërriten shqiptarë pa dallim feje, krahine dhe ideje (përjashtë mbështetësit e qeverisë) për t'i treguar vetes dhe botës - sidomos botës - se populli është me ne.

Studenti habitet kur mëson se populli po ikën! Nga 3.5 milionë banorë më 1994-n, pas 25 vjetësh



janë 2.5 milionë banorë.

2.5 milionë banorë, por në regjistra janë 3.5 milionë votues. Numri i popullsisë është ulur, por partitë politike, nga 5, janë bërë 65!

Studenti kujtohet për parullën: "E duam Shqipërinë si gjithë Europa". Ndaj tronditet kur i thonë se Serbia (që nga 1994-a deri në 1999-n ishte shkaku i katër luftërave), sot ka hapur bisedimet me BE-në. Nuk beson se Mali i Zi, vend i krijuar në 2006-n, diskuton kapitujt e anëtarësimit me Brukselin. Shqipëria, si pasagjerët që janë të vonuar për avionin, është ende në listë pritjeje.

Shqiptarët, aq entuziastë me politikën dhe partitë politike, sot janë mërzitur. Dy forcat kryesore politike ende nuk janë në një mend-

je për datën e çlirimit të vendit.

Nëse u beson sondazheve, mbi 50% nuk besojnë më te politika dhe sistemi aktual. Nëse njerëzit nuk besojnë në sistem, pyetja është: Duhet ndryshuar sistemi, apo populli?

Një dilemë që një student i dhjetorit as që e ka çuar dikur në mendje.

OPOZITA JASHTË SISTEMIT!

Opozita ka "djegur mandatet" dhe ka dalë nga sistemi. Opozita parlamentare është bashkuar me opozitën joparlamentare dhe janë bërë një! Për fat të keq, jashtë parlamentit. Nderkombëtarët janë në një mendje: precedent i rrezikshëm. Precedent që nuk ka ndodhur as me opozitën e Millosheviçit, as me opozitën e Malit të Zi, që është në opozitë që nga mba-

rimi i Luftës së Dytë Botërore.

Opozita ka një kërkesë: të shkojë në zgjedhje pa kryeministrin. Zgjedhjet parlamentare janë në vitin 2021.

Kriza duket pa zgjidhje. Beteja e ditës është të tregojë se kush ka pas vetes më shumë popull (ai që ka mbetur këtu).

Demokracia bashkë me liderët po kalon krizën e "moshës së mesme" (në vend të sjelljes së një të pjekuri zgjedh sjelljen e adoleshencës).

Nderkombëtarët duken po aq të lodhur sa edhe populli. Për çdo zgjidhje që ofrojnë, elita politike u paraqet një problem. Faik Konica, një shekull më parë, shkruante: "Shqiptarët u japin rëndësi groteske çikërrimave dhe injorojnë

gjërat thelbësore".

Zgjidhjet janë. Nuk ka nevojë të shpiket rrota. Opozita ka një kërkesë kryesore: zgjedhje pa kryeministrin. Kryeministri bashkë me ndërkombëtarët i druzhen precedentit. Precedenti mund të shmanget dhe vendin e tij ta zërrë standardi.

Një zgjidhje e ofron Greqia. Në djepin e demokracisë, para zgjedhjeve kryetari i Gjykatës së Lartë merr drejtimin e qeverisë dhe një ekip teknikienësh merr drejtimin e dikastereve qendrore. Zgjidhja për zgjedhjet parlamentare të 2021-shit mund të gjendet.

Çështja është që zgjidhja të kërkojë jo për dy muajt apo dy vitet e ardhshme, por për dy dekadat e ardhshme.

Zgjidhje që shqyrton me themel kapitullin 30-vjeçar të tranzicionit.

Për këtë zgjidhje nuk mjaftojnë dy javë, as dy muaj e ndosh-ta as dy vite.

Një zgjidhje që kur të zgjohej më 2039-n ai që "fle" sot të shohë se është ndërtuar një sistem zgjedhor ku njerëzit votojnë dhe zgjedhjet janë konkurruese; (jo vetëm në nivelin qendror, por edhe lokal) ku partitë politike i nënshtrohen ligjit si gjithë të tjerët, një sistem që jep shpresë se Shqipëria është një vend ku sundon ligji, ku drejtësia funksionon, ku media i shërben interesit publik dhe nuk është thjesht interesante për publikun, ku zyrtarët shërbejnë dhe ku zullumi nuk tolerohet.

Një zgjidhje që e bën Shqipërinë pritëse dhe jo përcjellëse të azilkerkuesve. Një zgjidhje që e bën vendin normal: vend ku ndërrohen elitat dhe jo populli; një vend ku azil kërkojnë oligarkët dhe jo populli. Një zgjidhje duke pasur në mendje jo karrigen e kryeministrit, por karrigen e vendit në BE.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIMIK.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE
MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



Analiza e gazetës prestigjioze italiane

"Gazzetta Dello Sport": Panuçi vështirë të përsërisë De Biazin

Kristian Panuçi ka marrë drejtimin e përfaqësueses shqiptare prej më shumë se një viti e gjysmë, por duket se deri tani nuk ka fituar besimin e tifozërisë kuqezi se mund të arrijë gjëra të rëndësishme me të. Për fatin e keq të teknikut italian, këtë opinion kanë edhe në vendlindjen e tij. Edhe pse përfaqësuesja shqiptare ka emra të njohur për italianët në përbërjen e saj,



përtej Adriatikut mendojnë se nuk do të përsëritet me historia e katër viteve më parë. Ndaj në prag të eliminatoreve të "Europianit

2020", e përditshmja sportive më e madhe italiane, "La Gazzetta Dello Sport", minimizon shanset që kanë kuqezinjët. Në analizën e saj për grupin G, ku bën pjesë edhe Shqipëria, rreshtohen sipas rëndësisë edhe përfaqë-

sueset dhe mundësitë e tyre për të arritur në fazën finale të turneut. "Kampionët e botës të Francës nuk duhet të ndjejnë rreziqe. Edhe pse të mundur nga Holanda në Ligën e Kombeve (humbja e parë që nga marsi 2018 në 16

ndeshje), nuk mund të kenë frikë Islandën zhgënjyese në Botëror dhe e rënë në Ligën B në Ligën e Kombeve, ndërsa nuk fiton që nga tetori 2017 (10 humbje e 7 barazime). Apo Turqinë e Çalhanoglu dhe Demiral të Sasuo-

los, e cila ka rënë në Ligën C dhe i beson ende 38-vjeçarit Emre dhe 33-vjeçarit Burak Jillmaz. Atëherë për vendin e dytë luan edhe Shqipëria e Kristian Panuçit, i cili vështirë se do të mund të përsëritë arritjen e kualifikimit të De Biazit, por që ka të "napolitani" Hysaj, të Taulant Xhaka dhe te lojtari i Peskarës, Memushaj, elementët më ekspertë. E mbyllin grupin Moldavia dhe Andorra", shkruan e përditshmja sportive italiane në analizën e saj.

Shpeshojnë në një fitore ndaj Turqisë, për ta nisur ashtu si me Portugalinë në eliminatore e "Euro 2016"

Veteranët pro Panuçit: Vendimet e tij, të drejta

Basha e Memushaj mbështesin hapur trajnerin



Jeton Selimi

Në konferencën për shtyp para dy ndeshjeve eliminatore të "Europianit 2020", mesfushori Migjen Basha u shpreh se atmosfera në ekip është e mirë, për Strakoshën ishte vendimi i trajnerit, teksa shtoi se Lenjani e ka marrë vetë vendimin dhe se konkurrenca i bën mirë skuadrës. Ky është edicion i ri dhe pritet shumë. "Të gjithë lojtarët e 2016-ës janë problem, pasi shumica e kanë lënë futbollin, por ndikon edhe moshja dhe ka pasur ndryshime. Atmosfera është e mirë dhe nuk ka pasur probleme me përgatitje si gjithmonë. Është ndeshja e parë dhe është me rëndësi. Në 2016-ën fituam në Portugal dhe shkoi gjithçka mirë. Duhet një fitore patjetër, pasi është e vështirë, sepse kemi kundërshtarë të fortë, por duhet të marrim këto 3 pikë. Atmosfera është e mirë dhe Strakosha e Lenjani kanë probleme, nuk duhet të jenë në grup. Lenjani e ka marrë vetë vendimin dhe nuk duhet të ndikojë. Për Strakoshën ishte gabim dhe vendim i tra-



nerit. Ne duhet të jemi të përqendruar dhe të stërvitemi".

Në konferencën për shtyp, mesfushori Ledian Me-

musaj është shprehur se ekipi ka shumë mungesa, megjithatë kjo nuk është justifikim, teksa duhet tentuar kalimi i grupit. Për

Memushajn, Liga e Kombeve ishte për t'u harruar. "Dua ta bëj dhe me Kombëtarën dhe nuk po mendoj çfarë kam bërë me klu-

bin. E rëndësishme është që Kombëtarja të arrijë sa më lart. Të gjithë lojtarët kanë minuta dhe është pozitive. Kemi shumë mungesa, por këto nuk duhen menduar. Duhet menduar ndeshja me Turqinë dhe duhet kaluar në ndeshje të vështira. Është pozitive që jemi me minuta. Andorrën nuk e njohim si ekip, kurse Turqia është ekip i mirë dhe ka lojtarë si Çalhanollu, që luan me Milanin. E dimë se çfarë na pret. Do merrja 2 kartonë të kuq, jo vetëm një, por që të fitojmë si në miqësore. Jam i kënaqur për Sadikun se e kam shok. Ka pasur dëmtim të vështirë dhe i dimë kualitetet e tij. Është i rëndësishëm për ne. Edhe Balaj ka bërë mirë kur ka luajtur".

Abramoviç nxjerr Çelsin në shtjje për 3 miliardë euro

Roman Abramoviç, manjati rus që zotëron klubin anglez të Çelsit, po mendon seriozisht ta nxjerrë në shtjje skuadrën e vetme londineze në histori që ka arritur të fitojë një Champions League. Abramoviç e bleu skuadrën nga Kin Bejts për shifrën e 140 milionë paundëve dhe në pak muaj e shndërroi Çelsin në një superfuqi botërore, duke fituar 5 tituj kampionë dhe kupën me "veshë të mëdha" në vitin 2012. Sipas "The Sun", Abramoviç mendon ta shesë klubin për një shifër rreth 3 miliardë euro, ndërsa kandidat i mundshëm për blerjen e bluve është Xhim Ratklif, një miliardar anglez, me një pasuri që arrin në 25 miliardë euro. Por, pavarësisht kësaj, Ratklif nuk duket i bindur për të shpenzuar shumën fillestare që Abramoviç kërkon.

VLERËSIMI I "FRANCE FOOTBALL"

Rinus Mishels, trajneri më i mirë i të gjitha kohërave

Babai i futbollit total dhe arkitekt në sukseset e para të Ajaksit të madh që dominoi Europën. Është Rinus Mishels, trajneri më mirë në historinë e sportit më të dashur në botë. Këtë e ka vendosur "France Football", revista prestigjioze, e cila në numrin e saj të fundit ka publikuar klasifikimin me teknikët më të mëdhenj të të gjitha kohërave. Në vendin e parë renditet Mishels, i cili ka meritën e vendosjes së bazave të para të futbollit modern kur drejtoi Ajaksin e Amsterdamin në vitet '60' dhe '70. Me interpretues të magjishëm, mjafton të përmendësh Johan Krojff, ai dominoi futbollin evropian, duke fituar gjithçka të mundshme. Po ashtu, nuk mund të har-



rohen sukseset që pasuan me Barcelonën si dhe me Kombëtaren e Holandës, siç ishte triumfi në Kampionatin Europian të vitit 1988. Në podin e më të mirëve në histori, Mishels ndiqet nga Sër Aleks Ferguson, trajneri legjendar i Manchester Junajtid dhe Arrigo Saki, që sipas "France Football" ka meritën "për ndryshimin e mentalitetit" në fut-

bollin italian, kur drejtoi Milanin. Pesëshja e parë e klasifikimit të 50 trajnerëve më të mirë të historisë së futbollit plotësohet me Johan Krojff dhe Pep Guardiolen, me këtë të fundit që i faturohet shpikja e "tiki-taka", modeli taktik i një loje spektakolare, që i ka lejuar të fitojë gjithçka, sidomos në kohën kur drejton-te Barcelonën.

Kërkon përjashtimin përjetë të gjyqtarit


Tirana: Olsi Sokoli, skandaloz dhe racist!

Pak me vonesë, por ka reaguar klubi i Tiranës për atë çfarë ndodhi në Fushë-Krujë, në ndeshjen me Kastriotin. Klubi bardheblu ka analizuar gjithçka me kujdes dhe tani kërkon përjashtimin e arbitrit Olsi Sokoli. Sipas klubit kryeqytetas, ky arbitër përveçse vendosi fatin e ndeshjes, ishte racist ndaj lojtarëve të Tiranës. Në reagimin e publikuar në faqen zyrtare, Tirana kërkon edhe reagimin e Shoqatës së Arbitrave për këtë çështje. "Klubi i Futbollit 'Tirana' dënon ashpër gjykimin skandaloz në ndeshjen Kastrioti-Tirana. Përgjatë 90 minutave të ndeshjes, gjyqtari Olsi Sokoli ka vendosur të ndikojë në rezultatin final të ndeshjes.

Fillimisht ka provokuar me shprehje raciste futbollistin Michael Ngoo e më tej ka dëmtuar skuadrën me vendimet arbitrare. KF 'Tirana' nuk është nxituar të dalë në konkluzione, por ka pritur për të ndjekur reagimet e të gjithë aktorëve dhe faktorëve brenda e jashtë fushave të lojës si dhe analizuar pamjet filmike për gjithçka ka ndodhur. Gjyqtari Olsi Sokoli ka vepruar i vetëm, pa dëgjuar asistentët e tij, që në disa momente vendimtare të ndeshjes i kanë kërkuar të marrë vendime të drejta, tërësisht të ndryshme nga çfarë ai ka vendosur. Fjalori me të cilin gjyqtari ka provokuar lojtarët e Tiranës dhe

stafin teknik janë një tjetër argument që bëjnë klubin të kërkojë një dënim radikal nga Federata Shqiptare e Futbollit dhe specifikisht nga Sektori i Arbitrimit. KF 'Tirana' kërkon përjashtimin nga futbollit të gjyqtarit Olsi Sokoli për një gjykim të pa precedent, komunikim ofendues dhe përdorimin e shprehjeve raciste kundrejt lojtarëve të Tiranës. Gjithashtu, ftojme publikisht Shoqatën e Arbitrave të reagojë kundrejt dhunës, që në këtë rast ushtroi një gjyqtar futbollit përballë 11 futbollistëve, stafit teknik, stafit drejtues dhe të gjithë tifozëve bardheblu".


Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL
1. Steiger aktor.
4. Mbetet në fund.
6. Ustinov i kinemasë.
11. Janë në modë.
12. Nuk e shqyen Danielin.
15. Një as i Milan.
16. Çobani aktore e jona.
18. I dyti në kapitull.
19. Dy asa në dorë.
21. Qe njeriu i parë që u dënua padrejtësisht.
23. Croft e Angelina Jolie.
24. Një që mbahet për mandan.
25. Para De Janeiro-s.
27. Gjysmë tandem.
29. Kap ndryshe.
30. Gjysmë tati.
31. Union Studentor Operativ.
33. Wallach aktor.
35. Pak spiunazh.
37. Ishin hipokritët e Jezu Krishtit.
38. Ai dhe ajo.

- 40. Një Madame e Maupassant.
41. Kështu thirrje Ernesto Guevara.
42. Fund ditari.
43. Pije piratësh.
45. Kush e thotë refuzon.
46. Të parat në sondazh.
47. Një makinë franceze.
48. Fillojnë stafetën.
49. Nisin nga fillimi.
50. Qan te Turandot.
51. Fundi i një samurai.
52. Umberto qe shkroi Lavrerësi i Foucault.
53. Dalë në krye.
VERTIKAL
1. Ajo e tretë u quajt Moskë.
2. Në hyrje të odës.
3. Me me për të penduarin.
4. Para... Gay në aeroplanin që ho dhi bombën atomike në Hiroshima.
5. Jepet për hartim.
7. Lindi edhe Cerberin.
8. Mbyllin pora.
9. Gjysma e ekipit.
10. Një inkursion me mig.
12. Fillojnë lehtë.
13. Eshhtë tretës me zorrë.
14. Pak tematike.
17. Qe mbreti jetëgjatë i Pilos.
20. Eshhtë ndalim me pranga.
22. Shkroi Këngëtarja tullace.
23. Eshhtë pikë vaji.
26. Ndajnë shtetet.
28. Kush nuk ka... s'eshhtë njoftuar.
32. Poetja e Lesbos.
34. Kështu shprehet komisarri Rex.
36. Fillojnë panikun.
38. Një liqen i kripur.
39. Inva soprano.
43. Inicialet e Altman
44. Një fjalë për sipër.
46. Të parat në stadium.
47. Fillojnë turnin.
48. Në hyrje të sokakut.
49. Fillojnë nazet


Fjalëkryqi (2)




- HORIZONTAL
3. Një pune... paguhet.
6. Para Zeppelin në grupin e famshëm.
8. Vincenzo, bomber te Roma.
12. Kufijtë e pritjes.
13. Një Arthur i Edgar Allan Poe.
16. Demek s'ka kufij.
18. Qe filozofi i shkollës eleatike.
19. Nino, kompozitor i famshëm italian.
21. Eshhtë ai që ka ngrityr krye.
23. Finlanda e... finlandezëve.
25. Mbledh basketë separatistë.
26. Inicialet e Prost.
28. Shkroi Cocktail party.
29. Titulli i Alex Ferguson.
30. Stile pa kufij.
32. Ishin greket që nuk vinin kurrë.
35. Unë dhe ti.
36. Hoxha që qe arbitër.

- 38. Eshhtë provë zjarri.
39. Majtas në fund.
41. Agjenci Ajrore Tiranë.
42. Eshhtë partia e Ariel Sharon.
43. Një mund të jetë çiklistik.
45. Të parat në sondazh.
46. E famshme ajo e psherëtimave.
47. Qendër ditore.
48. Një Baba përrallor.
49. Mund të jetë proteste.
50. Në fund të fundit.
VERTIKAL
1. Camille, indulgjenti që krijoi Vieux Corderier.
2. Në krye të solistëve.
3. Janë poetët si Ungaretti.
4. Ylli më i shndritshëm i Demit.
5. Janë kopjet si delja Dolly.
7. Një pjesë e dimensioneve.
8. Fillojnë muzikën.
9. Parafjala e prejardhjes.
10. Fernando, bomber i Liverpool.
11. Bisha aktore.
12. Ishin ushtarë të Kserksit.
14. Partia Demokratike.
15. Cepat e një ylli.
17. Ylli i baletit.
20. Pak amorali.
22. Mbushin enë pa fund në ferrin dantesk.
24. Italia në Internet.
27. Përhapet me frikë.
31. Mund të jetë françeskan.
33. Dehin pa kufij.
34. Eshhtë lënda për... rafte.
37. Gjysmë sahati.
39. Tatum që qe pianist.
40. Lloj papagalli.
42. Një pikë vaji.
44. Artikull spanjot.
45. Në krye të socialistëve.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

Table with 10 rows and 10 columns of letters for word search. Includes vertical labels 'PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR' and 'FJALËKRYQI (1)'. Words include: ARKKA, ASTRO, AMAMA, DIANA, HANTIK, ATLANTIK, OLIS, FEI, TARIFAT, LEIT, POLITIKANET, KENETA, ORAR, PAULIN, RRI, AK, EOT, AAD, DIM, RUMUNE, KIERA, ETJ, ITERI, AMAN, TEI, GORDIANE, INT, AROMA, TIT.

FJALËKRYQI (2)



SUDOK

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in. Numbers include 8, 7, 4, 1, 5, 6, 9, 4, 3, 8, 5, 2, 9, 6, 2, 5, 9, 4, 5, 6, 2, 5, 3, 9, 9, 4, 6.

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9x9 solved Sudoku grid. Numbers include 8, 2, 5, 7, 4, 6, 9, 1, 3, 9, 3, 4, 8, 1, 2, 5, 7, 6, 1, 6, 7, 3, 5, 9, 2, 4, 8, 3, 5, 8, 2, 9, 7, 4, 6, 1, 6, 9, 2, 1, 8, 4, 7, 3, 5, 7, 4, 1, 5, 6, 3, 8, 9, 2, 2, 8, 3, 9, 7, 1, 6, 5, 4, 4, 1, 9, 6, 2, 5, 3, 8, 7, 5, 7, 6, 4, 3, 8, 1, 2, 9.

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtimit filozofik

- Askush nuk është aq i pasur që të mos ketë nevojë për një buzëqeshje. Dhe askush nuk është aq i varfër që të mos mund ta jap!
- Ai që nuk sheh në errësirë, është ai që i kthen shpinën dritës.
- Nuk e ka fajin pasqyra... në qoftë se hunda juaj është e shtrembër.
- Kur jeni të sigurt që keni të drejtë, nuk ka nevojë për të diskutuar me ata që janë gabim.
- Njeriu inteligjent do të gjej rrugëdalje nga një situatë e vështirë. I mençuri nuk do të gjenden në këtë situatë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME Përgjigja e numrit të djeshëm

Two 10x10 grids for cryptogram. The first grid contains letters in a grid, and the second grid contains the corresponding decoded letters. Decoded words include: MIKE, KM, S, E, EKAROMAKET, KMIKITANTEET, PASANIKTAS, EKUANE TARET, RETE E IRANI, ITRBLAKEL, MIA RED EKI, EMETALEIS, TEKEMKUMT, MORAVIAMA.

Thënie të mençura

- Mos ki nevojë për asgjë, dhe do të kesh gjithçka.
- Mos ki nevojë për asnjë, dhe do ti kesh të gjithë.
- Nuk ka rëndësi se kush je dhe sa i bukur je, përderisa ekziston dikush që të dashuron.
- Heshtja e bën bisedën reale midis miqve. Ajo që ka rëndësi nuk është të flasësh, por të mos kesh nevojë për të folur.
- Kurrë mos ndiej keqardhje për atë që keni menduar për gruan tënde. Ajo ka menduar shumë më keq për ju.

